



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 670 Akti

Nr. 405 Vendimi
Tiranë, më 23.6.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleđa Çiftja	Kryesuese
Brunilda Bekteshi	Relatore
Lulzim Hamitaj	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, në datën 22.6.2021, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Abaz Muça**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bekteshi mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Abaz Muça, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të germës “b”, të pikës 7, të nenit 3 dhe pikës 9, të nenit 3, të rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, miratuar me vendimin nr. ***, datë 18.10.2019, Komisioni ka zhvilluar shortin në datën 15.12.2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Abaz Muça do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Lulzim Hamitaj, Brunilda Bekteshi dhe Etleda Çiftja. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bekteshi. Për shkak të kandidimit¹ të subjektit për drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, me përparësi nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 21.12.2020, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Abaz Muça, si dhe caktoi kryesuesen e trupit gjykues, komisioneren Etleda Çiftja. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

5. Në datën 11.1.2021, subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, në të njëjtën datë, deklaroi përmes postës elektronike marrjen dijani për njoftimin dhe trupin gjykues, si dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

6. Komisioni, në datën 10.6.2021, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Abaz Muça, për të tria kriteret e rivlerësimit: për pasurinë, figurën dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, të paraqesë pretendimet e tij brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 11.6.2021, subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda 10 ditëve. Brenda afatit të caktuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit dërgoi shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ në mënyrë elektronike dhe zyrtare.

8. Trupi gjykues, në datën 18.6.2021, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Abaz Muça, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016,

¹Referojuni shkresës nr. *** prot., datë 7.1.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

duke njoftuar në të njëjtën datë subjektin me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 22.6.2021, në orën 14:00, në Pallatin e Koncerteve Tiranë.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Abaz Muça u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar Elka Ermenkova. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

10. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Abaz Muça. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 22.6.2021 për të rifilluar në datën 23.6.2021 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

11. Z. Abaz Muça ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

12. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas kreut IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLGJ-ja është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese² dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

²Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

Në deklaratën e pasurisë, shtojca 2, dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.1.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti ka deklaruar:

1. Ndryshime të gjendjes *cash* – subjektit dhe bashkëshortja nga kursimet e pagës kanë gjendje *cash*, konkretisht: shumën 700.000 lekë, të mbajtur nga viti 2015 dhe nga kursimet e vitit 2016 kanë shumën 300.000 lekë (të destinuar për familjen). Vlera 700.000 lekë është mbajtur nga viti 2015 dhe 300.000 lekë janë mbajtur për vitin 2016.

Nga hetimi i Komisionit për këtë likuiditet ka rezultuar:

1.1 Subjekti i rivlerësimit deklaroi për herë të parë gjendje *cash* në DPV-në e vitit 2015 dhe më pas në vitin 2016.

1.2 Komisioni kreu analizën për mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit në krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar, ku nga përlllogaritjet e kryera u konstatua se subjekti rezultoi me balanca pozitive.

Tabela nr. 1

Nr.	Përshkrimi	2015	2016	26.1.2017
1	TË ARDHURA	2,027,510	1,988,094	168,064
	Të ardhura nga paga subjekti	1,486,523	1,444,555	122,610
	Të ardhura nga paga bashkëshortja	540,987	543,539	45,454
2	SHPENZIME	745,682	805,843	63,773
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	672,828	705,276	58,773
	Shpenzime qiraje (banesë 1+1) 5.000 lekë/muaj	60,000	60,000	5,000
	Shpenzime telefonike (<i>vodafone</i>)	12,854	12,160	-
	Shpenzime sipas sistemit <i>TIMS</i>	-	28,407	-
3	PASURI	668,776	324,849	20,339
	<i>Ndryshim Likuiditeti</i>	668,776	324,849	20,339
	DIFERENCA (1-2-3)	613,052	857,403	83,952

1.3 Trupi gjykues, lidhur me këtë likuiditet *cash*, pas analizimit të dokumentacionit të administruar në dosje dhe fakteve të dala gjatë hetimit arsyetoi se: (i) sa i takon vërtetësisë së deklaramëve ka rezultuar se subjekti i ka deklaruar likuiditetet *cash* në shumat respektive për vitet 2015 dhe 2016, sipas deklaratës *Vetting*; (ii) lidhur me verifikimin e mundësive financiare për të krijuar këto likuiditete *cash*, Komisioni pas përlllogaritjeve të kryera mes raportit të të ardhurave të ligjshme dhe shpenzimeve, konstatoi se subjekti ka pasur mundësi të krijojë gjendjen *cash* të deklaruar, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare, duke konkluduar se ka përmbushur parashikimet ligjore të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2014.

2. Subjekti ka deklaruar se nga kursimet e mbledhura nga paga në vitin 2008, i ka dhënë hua shumën 310.000 lekë vëllait I. M., për arsye shëndetësore. Në vijim ka deklaruar se pas emigrimit të tij në Greqi këtë shumë ia ka kthyer dhe e disponon *cash* për nevoja familjare dhe shëndetësore, si dhe në vitin 2009, përmes Western Union i ka nisur për nevoja urgjente shumën 200 euro vëllait H. M. (ka pësuar një aksident, djegie në punë), shumë e kthyer dhe e përdorur për nevoja familjare.

2.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: “Subjekti ka deklaruar huan në vitin 2008, por nuk ka deklaruar kthimin e saj”.

2.2 Subjekti në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, në vitin 2008, ka deklaruar se i ka dhënë hua vëllait të tij, për arsye shëndetësore, shumën 310.000 lekë, me burim nga kursimet e tij të pagës, si oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Mat për periudhën 2001 – 29.7.2008.

2.3 Komisioni kreu analizën financiare në momentin e dhënies së huas, duke përfshirë të ardhurat e përfituara në periudhën 2001 – 29.7.2008, si dhe shpenzimet përkatëse të kësaj periudhe.

Tabela nr. 2

Nr.	Përshkrimi	2001-29.7.2008
1	TË ARDHURA	5,430,511
	Të ardhura nga paga subjekti	4,688,296
	Të ardhura nga paga bashkëshortja ³	742,215
2	SHPENZIME	2,197,186
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së ⁴	1,572,186
	Shpenzime qiraje (banesë 1+1) 5.000 lekë/muaj	215,000
	Elektroshtëpiake/arredim	100,000
	Hua ndaj vëllait	310,000
3	PASURI	70,090
	Gjendje në bankë	70,090
	DIFERENCA (1-2-3)	3,163,234

2.4. Lidhur me huan në shumën 310.000 lekë, dhënë vëllait I. M., si dhe shumën prej 200 euro, dhënë vëllait tjetër H. M., trupi gjykues ka konstatuar se subjekti e ka deklaruar këtë hua në deklaratën para fillimit të detyrës, por në kushtet që nga viti 2008 e në vazhdim subjekti nuk e ka deklaruar kthimin e kësaj shume në asnjë nga deklaratat periodike dhe nuk ka deklaruar edhe veprimin e vitit 2009, ku në analizën financiare nuk ka përfshirë kthimin e huas, si dhe dërgimin dhe kthimin e shumës 200 euro në këtë vit. Me gjithë këtë, trupit gjykues, bazuar në përlllogaritjet financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve për vitet kur janë kryer këto huadhënie, i ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi t'i japë hua vëllait, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare, duke mos evidentuar ndonjë problematikë.

Detyrime financiare

3. Subjekti ka deklaruar se nuk ka ndryshime, pra, nuk ka detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë.

4. Gjithashtu, subjekti konfirmon se në vitin 2007 ka marrë, pra, ka tërhequr përmes Western Union, shumën 700 euro (2 dërgesa), dërguar nga vëllai i tij I. M., të nisura nga Greqia, i cili i ka dërguar si ndihmë për prindërit që banojnë në fshatin ***, Dibër (pasi rruga ishte bllokuar për shkak të dëborës dhe nuk mund të paraqiteshin për t'i tërhequr). Po kështu, ka deklaruar se ka tërhequr në vitin 2015, në "Raiffeisen Bank", shumën 200.000 lekë me prokurë të lëshuar nga vëllai H. M. (pasi ndodhej në Greqi), për tërheqje parash nga depozita (ndihmë për t'i dërguar te prindërit, për arsye shëndetësore, konkretisht për babain).

4.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: "Subjekti nuk ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues, referuar deklaramit të subjektit, transferta është bërë nëpërmjet sistemit bankar dhe

³Të ardhurat e bashkëshortes janë marrë nga viti 2005 sipas *statement*-it në "Raiffeisen Bank".

⁴Për periudhën 2001-2004 shpenzimet janë përlllogaritur për një person, ndërsa nga viti 2005 sipas përbërjes familjare së subjektit (2 dhe 3 persona).

për ndihmë financiare për prindërit. Subjekti nuk e ka deklaruar në vitin 2015 tërheqjen në 'Raiffeisen Bank' për prindërit me prokurë nga vëllai”.

4.2 Deklarimi i subjektit nuk korrespondon me rubrikën e detyrimeve financiare, pasi nga hetimi dhe nga deklaratimet e tij nuk rezulton që të ketë detyrime ndaj të tretëve.

4.3 Transaksioni i vitit 2007, i kryer nëpërmjet Western Union, nuk provohet me dokumentacion dhe është një veprim që i përket periudhës para emërimit të subjektit të rivlerësimit, pra, para detyre.

4.4 Komisioni i ka kërkuar⁵ subjektit të rivlerësimit *statement* të llogarisë së vëllait H.M., në “Raiffeisen Bank”, si dhe prokurën e lëshuar nga ky i fundit për transaksionet e kryera.

4.4.i Subjekti ka depozituar dokumentacionin e kërkuar: (i) prokurë e posaçme nr. ***, datë 18.4.2005, lidhur mes shtetasve H. dhe Abaz Muça. I përfaqësuar H.M. i jep të drejtë përfaqësimi vëllait të tij Abaz Muça që ta përfaqësojë pranë “Raiffeisen Bank”, në Dibër, për të kryer veprimet, tërheqje dhe depozitime në llogari; (ii) *statement* në “Raiffeisen Bank”, në emër të vëllait të subjektit të rivlerësimit, shtetasit H.M. .

4.5 Nga dokumentacioni i depozituar vihet re se prokura është lëshuar në vitin 2005 dhe se në akt, qartazi, pasqyrohet tagri i dhënë subjektit nga i vëllai mbi të drejtën e kryerjes së veprimeve (tërheqje/depozitim) në llogarinë e tij bankare.

Nga *statement*-i i “Raiffeisen Bank” vihet re se llogaria/depozita në emër të vëllait të subjektit të rivlerësimit, shtetasit H. M., daton që prej vitit 2005.

Gjithashtu, vërehet se në këto llogari subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer depozitime, por rezultojnë vetëm dy tërheqje, përkatësisht: në datën 8.7.2014, shtetasi Abaz Muça ka tërhequr shumën 200.000 lekë; dhe në datën 28.8.2015 ka tërhequr shumën 200.000 lekë.

4.6 Nga sa më sipër, trupi gjykues arsyeton se në tërësi të fakteve të dala rezulton se: (i) veprimet e vitit 2015, dy tërheqjet me vlerë nga 200.000 lekë, kryer me prokurë nga llogaria e vëllait, për prindërit e tij, nuk janë të ardhura shtesë për subjektin, hua apo shpenzim i tij; (ii) nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje (prokura e lëshuar në vitin 2005), provohet fakti se i përfaqësuar/vëllai i ka dhënë tagrin subjektit mbi të drejtën e kryerjes së veprimeve (tërheqje/depozitim) në llogarinë e tij bankare, duke u shfaqur vetëm si ndërmjetës/përfaqësues në kryerjen e këtyre transaksioneve; (iii) nuk rezulton që shumat të jenë përdorur prej tij apo t’i ketë deklaruar si burim krijimi për ndonjë pasuri; (iv) këto shuma nuk janë përfshirë në analizën financiare të kryer për subjektin e rivlerësimit, për rrjedhojë, në tërësi të rrethanave dhe fakteve të dala nga hetimi për këto veprime bankare të subjektit, trupi gjykues konkludon se nuk konstatohen problematika.

Të dhëna konfidenciale

5. Subjekti ka deklaruar se nuk ka asnjë lloj ndryshimi në pasuritë private të paluajtshme apo të luajtshme, pasi nuk disponon të tilla. Subjekti deklaroi se ka një banesë me qira marrë shtetasit S. Gj., ku banon me familjen, e cila ndodhet në adresën: p. ***, k. ***, lagja “****”, Burrel. Për këtë banesë paguan qira në vlerën 5.000 lekë/muaj, si dhe detyrimet e ujit dhe energjisë elektrike i paguan personalisht. Lidhur me këtë banesë disponon deklaratën e shtetasit S. Gj. që është pronar, si dhe vërtetimin e lëshuar nga ZVRPP-ja Mat për këtë shtetas.

5.1 Së bashku me deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka depozituar⁶: deklaratë të panoterizur të shtetasit S. Gj., i cili deklaroi se ka në pronësi një banesë apartament 1+1, në katin e katërt, në lagjen “****” Burrel, të cilën ia ka lëshuar me qira shtetasit Abaz Muça nga janari i vitit 2005, me vlerë qiraje 5.000 lekë/muaj. Shtetasi Abaz Muça paguan energjinë

⁵Pyetësor nr. 2, datë 30.4.2021.

⁶Aneks nr. 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së.

elektrike me kontratën nr. *** me OSHEE-në, e lidhur në emër të shtetasit R. T., person i cili ka banuar me parë në këtë banesë. Gjithashtu, shtetasi Abaz Muça paguan detyrimet e ujit me kontratën nr. *** me UKT-në, që është në emër të deklaruesit S.Gj.; vërtetimin nr.*** prot., datë 11.10.2016, nga ZVRPP-ja Mat, i cili konfirmon se shtetasi S. Gj. ka në pronësi apartamentin me sip. 61.3 m², z. k. ***, vol. ***, f. ***, Burrel⁷; vërtetimin nr. ***, datë 11.10.2016, nga ZVRPP-ja Mat, sipas të cilit shtetasi Abaz Muça nuk disponon pasuri të regjistruar pranë kësaj zyre në z. k***, Mat.

5.2 Nga hetimi⁸ i kryer nuk rezulton ndonjë pasuri në emër të subjektit të rivlerësimit.

5.3 Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar se: *“Jetoj në një banesë me qira në Burrel (1+1), 5.000 lekë/muaj”*.

5.4 Nga deklarata e parë e vitit 2008 dhe në vazhdim, subjekti deklaroi si vendndodhje banimi, lagjen “****”, Burrel, ndërkohë që ka deklaruar në pyetësin nr. 1 se ka jetuar që prej vitit 2005 në këtë apartament me këtë adresë dhe me të njëjtën vlerë qiraje.

5.5 Komisioni e ka pyetur⁹ subjektin lidhur me pasurinë e marrë me qira, kryesisht për faktin se nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se qiradhënësi S. Gj. kishte fituar në vitin 2009 këtë pasuri, ndërsa subjekti ka deklaruar se këtë apartament e ka marrë me qira prej vitit 2005 nga bashkëshortët Gj. .

Subjekti, në përgjigjen e tij, ka shpjeguar se apartamentin ia ka marrë me qira bashkëshortëve Gj. prej të cilëve është vënë, gjithashtu, në dijeni se ishin pronarë të pasurisë. Subjekti deklaroi se qiradhënësi provon pronësinë *de jure* të pasurisë me kartelën e pasurisë datë 30.12.1999, për apartamentin me sip. 61.3 m², që ndodhet në z. k. ***, vol. ***, f. *** dhe ka nr. ***, me vendndodhje në Burrel, Mat. Gjithashtu, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale¹⁰, dhënë nga shtetasi S. Gj., i cili ka deklaruar se ka blerë apartamentin e përkthyer më sipër në vitin 1994 nga shtetasi M.P. dhe se në këtë banesë ka jetuar deri në vitin 2000 dhe më pas është zhvendosur në Tiranë. Subjekti ka depozituar, gjithashtu, edhe certifikatat e pasurive, si dhe kontratën e shkëmbimit për pasurinë nr. ***, datë 12.8.2009, lidhur midis qiradhënësve dhe një shtetasi tjetër.

Në deklaratën noteriale qiradhënësi ka deklaruar se *në vitin 1995 ka marrë shtëpi nga EKB-ja me kontratë të përkohshme në lagjen “****” Burrel, të cilën më tej ia ka shitur në datën 23.11.1999 shtetasit M.H., shtëpi e cila sipas deklaruesit ka qenë në formë kredie nga EKB-ja. Atëherë shtetasi Gj., për t’i dhënë garanci kolaterale shtetasit M.H., kanë lënë si garanci shtëpinë e ndodhur në lagjen “****”, pra shtëpinë e dhënë me qira subjektit. Pasi ka shlyer detyrimet në EKB, shtetasi S.Gj. ka kryer veprimet në hipotekë për t’i kaluar pronësinë shtetasit M.H., për banesën në lagjen “****”*. Po sipas deklaratës, shtetasi S. Gj. ka deklaruar se në banesën në lagjen “****”, shitur shtetasit M.H. nuk ka banuar asnjë ditë, por ka banuar deri në vitin 2000 në shtëpinë e dhënë me qira subjektit të rivlerësimit. Shtetasi S.Gj. ka deklaruar se përpara se subjekti të banonte në këtë apartament, ka banuar shtetasi R.T., ku detyrimet e energjisë elektrike janë paguar nga subjekti në emër të këtij të fundit, kontratë e cila nuk ishte ndryshuar për shkak se shtetasi R.T. ishte larguar jashtë vendit dhe se duhet të ishte prezent për prishjen e saj. Sipas subjektit, shkëmbimi *de facto* i pasurisë është bërë më herët, pra, përpara vitit 2005, ndërsa veprimet juridike janë bërë në vitin 2009 dhe nga aktet rezulton se shkëmbimi *de jure* i pasurive është bërë në gusht të vitit 2009.

⁷Edhe ZVRPP-ja Burrel, me e-mailin e datës 13.12.2018, konfirmon se pasuria me nr. ***, vol. ***, f. ***, z.k. ***, në qytetin e Burrelit është në bashkëpronësi të shtetasve S. R.Gj. dhe N.Sh.Gj. . Bashkëlidhur kartela e pasurisë së paluajtshme (Aneks nr. 28 në dosjen e ILDKPKI-së).

⁸Aneks nr. 27, në dosjen e ILDKPKI-së si dhe nga aksesi institucional me ASHK-në.

⁹Me pyetësin nr. 4, datë 26.5.2021.

¹⁰Nr. ***, datë 27.5.2021.

5.6 Trupi gjykues, pas analizimit të dokumentacionit dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ për këtë pasuri, arsyeton:

5.6.1 Lidhur me deklaratimet e subjektit për pasurinë që përdor me qira, Komisioni ka konstatuar se e ka deklaruar përdorimin e kësaj pasurie “*si adresë banimi, lagja ‘***’, Burrel*”, që në deklaratën e vitit 2008 dhe në vazhdim, në përputhje të plotë me deklarin e tij në pyetësorin standard nr. 1: “... *se ka jetuar që prej vitit 2005 në këtë apartament me këtë adresë...*”, si dhe me deklarin në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, të personit të lidhur me të/bashkëshortes.

5.6.2 Lidhur me mënyrën e përfitimit të pasurisë nga qiradhënësi, në kuadër të shterimit të çdo dyshimi të arsyeshëm për lidhje të mundshme të subjektit me këtë pasuri, trupi gjykues çmon se shpjegimet janë bindëse, si dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion prej tij, provohet pronësia *de jure* e pasurisë me kartelën e pasurisë, datë 30.12.1999, në emër të qiradhënësit. Në analizë të dokumentacionit të administruar, trupi gjykues ka konstatuar se subjekti referon për transaksione të kryera mes qiradhënësit me palë të tjera dhe, në tërësi të fakteve të dala, u konstatua se nuk diktohej ndonjë lidhje e subjektit me pronësinë e kësaj pasurie të marrë me qira prej tij, që në vitin 2005, kohë kur ende nuk kishte nisur funksionin e prokurorit. Në kushtet që nga hetimi administrativ nuk u konstatua as ekzistenca e ndonjë konflikti të mundshëm të interesit¹¹, midis subjektit të rivlerësimit për shkak të detyrës së tij funksionale dhe qiradhënësve, trupi gjykues çmon se subjekti ka deklaruar me saktësi përdorimin e kësaj pasurie sipas pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2014.

Hetimi për pasuritë e prindërve

6. Subjekti ka konfirmuar se babai i tij ka të regjistruar në emrin e tij në z. k. *** (fshati ***, Dibër), tokë bujqësore me sip. 3864 m², në të cilën përfshihet edhe trualli i banesës me sip. 312 m², ndërtesë me sip. 81 m², të cilën e ka marrë në mbështetje të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”. Subjekti ka depozituar vërtetimin, datë 20.10.2016, të ZVRPP-së Dibër dhe kopje të AMTP-së, në emër të shtetasit Q. H. M. .

6.1 Subjekti i rivlerësimit, së bashku me deklaratën *Vetting*, ka depozituar¹²: vërtetimin datë 20.10.2016, nga ZVRPP-ja Dibër, i cili vërteton se në emër të shtetasit Q. M. është e regjistruar në z. k. ***, tokë bujqësore me sip. 3.864 m², në ***, në të cilën përfshihet truall me sip. 312 m² dhe ndërtesë me sip. 81 m² (origjinal dhe fotokopje); ATMP me nr. *** regj., datë 20.1.1994, në emër të shtetasit Q. M., i cili ka në pronësi tokë bujqësore me sip. 5.370 m², në fshatin ***, Dibër (origjinal dhe fotokopje).

6.2 ILDKPKI-ja, në raportin e tij, është shprehur: deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Peshkopi. Subjekti ka deklaruar pasuri të paluajtshme në emër të babait të tij, të cilin nuk e ka në përbërje familjare.

6.3 Nga dokumentacioni i administruar¹³ rezultoi se ZVRPP-ja Peshkopi konfirmon se shtetasi Q.H.M. ka të regjistruar në z. k. *** (***) Dibër, këto pasuri të paluajtshme: lloji i pasurisë “arë”, me sip. 324 m², vol. ***, f. ***; lloji i pasurisë “arë” me sip. 368 m², vol. ***, f. ***; lloji i pasurisë “arë” me sip. 400 m², vol. ***, f. ***; lloji i pasurisë “arë” me sip. 900 m², vol. ***, f. ***; lloji i pasurisë “arë” me sip. 1.560 m², vol. ***, f. ***; lloji i pasurisë “truall” me sip. 312 m², vol. ***, f. ***, nga i cili ndërtesa me sip. 84 m².

6.4 Këto pasuri janë të regjistruara si përfaqësues të familjes bujqësore me AMTP-në nr. ***. Ky institucion, por edhe subjekti kanë depozituar kopje të AMTP-së.

¹¹Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat¹¹ nuk ka konfirmuar ndonjë proces hetimor me vendimmarrje mosfillimi, pushimi, pezullimi apo dërgimi të çështjes për gjykim nga subjekti i rivlerësimit ndaj këtyre shtetasve. Po ashtu, edhe subjekti ka deklaruar të njëjtin fakt.

¹²Aneks nr. 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹³Me e-mailin, datë 13.12.2018/Aneks nr. 29 në dosjen e ILDKPKI-së.

6.5 Shtetasi Q.H.M. ka pasur të regjistruar, me po të njëjtin numër akti, llojin e pasurisë “arë” me sip. 572 m², pasuri të cilën e kaluar me akt noterial, nr. ***, datë 25.2.2002, për pjesëtim pasurie të paluajtshme te shtetasi I. Q. M. .

6.6 Nga dokumentacioni i administruar konfirmohet pasuria në emër të babait të subjektit. Gjithashtu, konfirmohet se kjo pasuri është përfituar me AMTP. Rezulton se me kontratën e pjesëtimit nr. ***, datë 25.2.2002, të gjithë anëtarët e familjes, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, i kanë dhënë vëllait të subjektit, shtetasit I. M., pjesën e tij takuese nga pasuria e përbashkët e familjes bujqësore. Subjekti i rivlerësimit, për shkak të parashikimeve ligjore të ligjit nr. 7501/1991¹⁴, duket të ketë qenë përfitues në këtë pasuri.

6.7 Komisioni, nga verifikimi i deklaratave periodike, konstatoi se subjekti nuk ka e deklaruar këtë pasuri¹⁵/pjesën takuese, si dhe nuk e kishte deklaruar në emër të tij këtë pasuri në deklaratën *Vetting*, duke i kërkuar shpjegime subjektit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

6.8 Lidhur me konstatimin e Komisionit sipas pikës 6.7, subjekti i rivlerësimit në qëndrimin e tij ka shpjeguar se:

- i) babai i tij ka të regjistruar në emër të tij në z. k. nr. *** (fshati ***, Dibër) tokë bujqësore me sip. 3.864 m², në të cilën përfshihet edhe trualli i banesës me sip. 312 m² dhe ndërtesë me sip. 81 m², të cilën e ka marrë në mbështetje të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”. Subjekti ka depozituar vërtetimin datë 20.10.2016 të ZVRPP-së Dibër dhe kopje të AMPT-së në emër të shtetasit Q. H. M.;
- ii) shtetasi Q. H. M. ka pasur të regjistruar me po të njëjtin nr. akti, llojin e pasurisë “arë” me sip. 572 m², pasuri të cilën e ka kaluar me akt noterial nr. ***, datë 25.2.2002, për pjesëtim pasurie të paluajtshme, te shtetasi I. Q. M.;
- iii) nga kjo tokë bujqësore me sip. 3.864 m², që ka deklaruar, ka marrë vetëm një pjesë pasurie tokë arë me sip. 572 m², me akt noterial nr. ***, datë 25.2.2002, me pjesëtim pasurie të paluajtshme vëllai i tij, shtetasi I. Q. M., i cili është ndarë nga trangu familjar që në vitin 1996;
- iv) praktika e regjistrimit të kësaj pasurie në ZVRPP-në Dibër, ashtu siç përcaktohet edhe në aktet nënligjore, është ndjekur nga kryetari i familjes bujqësore Q.M. ;
- v) neni 222 i Kodit Civil parashikon se: “*Pasuria e familjes bujqësore është në bashkëpronësi në tërësi të anëtarëve të familjes bujqësore, të cilët me punë apo në mënyra të tjera kanë kontribuar në krijimin e në mbajtjen e familjes bujqësore*”. Referuar kësaj dispozite, anëtarët e familjes bujqësore janë bashkëpronarë në tërësi, kur kanë kontribuar jo vetëm me krijimin e familjes bujqësore, por edhe në mbajtjen e saj, pasi dispozita ka të vendosur lidhëzën “e” jo “ose”. Ndërsa, në nenin 223 të Kodit Civil përcaktohet se: “*Anëtarët e familjes bujqësore janë të lidhur me njëri-tjetrin për shkak gjinie, martese, birësimi apo pranimit si anëtarë të saj*”. Gjithashtu, në nenin 227 të Kodit Civil dhe nga interpretimi në tërësi i dispozitave të Kodit Civil që rregullojnë familjen bujqësore, anëtarët e familjes bujqësore janë ata që kontribuojnë dhe punojnë së bashku për krijimin dhe shtimin e pasurisë së familjes bujqësore dhe në varësi të kontributit të tyre për krijimin apo shtimin e pasurisë së familjes bujqësore, përcaktohet edhe pjesa e tyre në këtë familje;
- vi) mosdeklarimi i pronësisë për pjesën takuese mbi këtë sipërfaqe toke bujqësore prej vëllait I.Q.M., ka ardhur për shkaqe tërësisht objektive, që lidhen me situatën faktike të krijimit dhe regjistrimit të kësaj pasurie, si dhe burimi i kësaj pasurie është i ligjshëm, përfituar në bazë të një akti administrativ, i cili është lëshuar në bazë të ligjit nr. 7501/1991;

¹⁴Subjekti, në pyetësin nr.1, ka deklaruar se deri në janar të vitit 2005 se ka jetuar te prindërit e tij së bashku me anëtarët e tjerë të familjes me kryefamiljar babain e tij.

¹⁵Ku për sipërfaqen 33864 m², subjekti ka deklaruar në pyetësin nr.1 se ajo nuk është ndarë.

- vii) kjo pasuri ka qenë një ndër pasuritë e përfituara me AMTP-në nr. ***, datë 20.1.1994, në emër të babait të tij, i cili edhe në vitin 2002, nga kjo pasuri e përbashkët e familjes bujqësore, ka marrë pjesën takuese vëllai i tij I. Q. M., si kanë hequr dorë vullnetarisht nga pjesa takuese, pavarësisht se nuk janë kryer veprimet juridike tek institucionet përkatëse;
- viii) lidhur me këtë tokë bujqësore, nuk ka deklaruar apo përfutuar asnjëherë të ardhura prej saj.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

6.9 Trupi gjykues, në analizë të provave të administruara, fakteve dhe rrethanave të cilësuar më sipër, si dhe parashtrimeve të subjektit, arsyeton si vijon:

Vlerësuar në aspektin e deklarimeve, trupi gjykues ka konstatuar se në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri në emër të babait të tij dhe nuk e ka deklaruar¹⁶ në deklaratat periodike. Në këtë drejtim, trupi gjykues, bazuar në aktet e administruara, vlerëson se subjekti i rivlerësimit sipas gjendjes familjare para vitit 1991, ka qenë pjesëtarë i familjes bujqësore dhe sipas ligjit nr. 7501/1991, ligjvënësi e njohu bashkëpronësinë mbi tokën bujqësore për të gjithë ata anëtarë të familjeve shqiptare që banonin dhe jetonin në fshat apo në ferma të ndryshme, por që ishin në përbërjen familjare të familjes bujqësore para daljes së ligjit nr. 7501/1991. Bazuar në nenin 222 të Kodit Civil, anëtarët e familjes bujqësore tërheqin të drejta reale pronësore mbi pasurinë e mësipërme dhe sipas germës “a”, të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, subjekti ka pasur detyrimin ligjor t’i deklaronte këto pasuri dhe të drejtat reale mbi to sipas Kodit Civil.

6.10 Trupi gjykues, bazuar në dispozitat ligjore të Kodit Civil, arsyeton se bashkëpronësia midis anëtarëve të familjes bujqësore paraqitet si bashkëpronësi në tërësi dhe, për sa kohë, është bërë pjesëtimi për një pjesë të kësaj sipërfaqeje toke, sipas nenit 207 të Kodit Civil, subjekti duhet të deklaronte të drejtat reale për sipërfaqen e mbetur ndaj së cilës zbatohen rregullat e përgjithshme dhe të posaçme të Kodit Civil për disponimin mbi to. Në këto rrethana, trupi gjykues çmon se subjekti: (i) duhet të kishte deklaruar të drejtat reale të kësaj pasurie në emrin e tij në deklaratën *Vetting* për sipërfaqen e mbetur pas këtij pjesëtimi; si dhe (ii) duhet të kishte deklaruar në deklaratat periodike të drejtat reale për këtë pasuri.

6.11 Trupi gjykues, pavarësisht sa më sipër arsyetuar, nën çmuarjen e rrethanave faktike se: (i) subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në emër të babait të tij në deklaratën *Vetting*; (ii) nuk janë deklaruar apo pretenduar të ardhura nga kjo tokë bujqësore për ndonjë pasuri tjetër; (iii) nga hetimi administrativ u provua fakti se kjo tokë bujqësore është përfutuar në bazë të ligjit nr. 7501/1991, çmon se është përpara një pasaktësie të subjektit për këtë deklaram, e cila e vlerësuar si e vetme në deklaramet e tij, për kriterin e pasurisë, konkludon se nuk mund të ngrihet në nivelin e ndonjë shkaku ligjor¹⁷ për penalizimin e subjektit në kuadër të këtij procesi.

7. Subjekti ka deklaruar se nuk ka asnjë lloj marrëdhënie me subjekte fizike apo juridike që mbartin detyrimin për deklaram.

Deklarimi i pasurive të personit të lidhur, të bashkëshortes së subjektit/A.M.

8. Bashkëshortja e subjektit ka deklaruar se nuk ka pasuri. Nga hetimi administrativ¹⁸ i kryer nuk rezultojnë pasuri të luajtshme apo të paluajtshme në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

Detyrime financiare

¹⁶Ku për sip. 33864 m², subjekti ka deklaruar në pyetësorin nr.1 se ajo nuk është ndarë.

¹⁷Referuar dhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, vendimi nr. 32, datë 21.11.2019, paragrafi 78.

¹⁸Nga aksesi institucional në ASHK.

9. Bashkëshortja e subjektit ka deklaruar se nuk ka detyrime financiare ndaj personave fizikë apo juridikë.

10. Në vijim, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar se nuk ka asnjë lloj ndryshimi në pasuritë private të paluajtshme apo të luajtshme, pasi nuk disponon.

11. Bashkëshortja e subjektit ka deklaruar se ka një banesë me qira, marrë shtetasit S.Gj., ku banon me bashkëshortin dhe fëmijën në moshën 11-vjeçare. Kjo banesë ndodhet në pallatin nr. ***, kati***, në lagjen “****”, Burrel. Për këtë banesë paguajnë qiranë 5.000 lekë/muaj, si dhe detyrimet e ujit dhe energjisë elektrike. Gjithashtu, lidhur me këtë banesë disponojnë deklaratën e shtetasit S.Gj. që është pronar, si dhe vërtetimin lëshuar nga ZVRPP-ja Mat.

Lidhur me banesën e marrë me qira, Komisioni e ka trajtuar dhe arsyetuar këtë çështje në pikën 5 të vendimit, nga ku nuk kanë rezultuar problematika.

12. Bashkëshortja e subjektit ka konfirmuar se babai i saj ka të regjistruar në emër të tij në pronësi (fshati ***, Lushnjë) tokën bujqësore me sip. 25.783 m², të cilën e ka marrë në mbështetje të ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”. Subjekti ka depozituar kopjen e AMPT-së në emër të shtetasit M.L.B. .

12.1 Subjekti i rivlerësimit, së bashku me deklaratën *Vetting*, ka depozituar AMTP-në nr. ***, datë 15.6.1992, në emër të shtetasit M. B., sipas të cilit rezulton se ka në pronësi tokën bujqësore me sip. 25.783 m² dhe në përdorim tokën me sip. 1.319 m², në fshatin ***, Lushnjë, si dhe një kopje të ID-së.

12.2 Nga dokumentacioni¹⁹ i administruar, ZVRPP-ja Lushnjë konfirmon se shtetasi M.B. ka përfituar me AMTP nr. ***, datë 15.6.1992, pasuritë: pasuria e llojit “arë+truall” me sip. 8.355 m², 200 m² truall, nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. 110 dhe sipërfaqe nga regjistrimi fillestar sistematik masiv 9.480 m², 200 m² truall dhe 95 m² ndërtesë, në fshatin ***, Lushnjë; pasuria e llojit “arë”, me sip. 11.874 m² nr. pasurie ***, z. k. ***, vol.***, f. *** dhe sipërfaqe nga regjistrimi fillestar sistematik masiv 11.653 m², në fshatin ***, Lushnjë; pasuria e llojit “arë”, me sip. 5.554 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, dhe sipërfaqe nga regjistrimi fillestar sistematik masiv 5.400 m², në fshatin ***, Lushnjë. Ky institucion ka depozituar²⁰ AMTP nr. *** dhe kartelat e pasurive.

12.3 Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar, ka konstatuar se edhe pse bashkëshortja e subjektit nuk e ka në përbërje familjare babain e saj, e ka deklaruar këtë pasuri, e cila konfirmohet sipas deklarimeve të saj, si dhe në kushtet kur edhe nga hetimi administrativ nuk u evidentua ndonjë fakt tjetër që mund të krijonte ndonjë dyshim të arsyeshëm për çështje që lidhen me rivlerësimin e subjektit, konkludon se nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë pasuri.

13. Komisioni, lidhur me kriterin e pasurisë ka verifikuar edhe të dhënat e dala nga institucionet publike²¹ AMF, RNSH apo edhe nga sistemi *TIMS*, nga ku nuk kanë rezultuar problematika apo dyshime për përdorim automjetesh, dalje të regjistruara në sistemin *TIMS* me mjete të padeklaruara apo kontrata të nënshkruara pranë noterit publik nga/dhe në adresë të subjektit.

Konkluzion në lidhje me kriterin e pasurisë

Trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, mbështetur në parimin e objektivitetit, konkludon se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin dhe se nuk janë evidentuar elementë apo *indicie* që të ndikojnë në procesin e

¹⁹Me e-mailin, datë 13.12.2018, aneks nr. 30, në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁰Aneks nr. 30, në dosjen e ILDKPKI-së.

²¹Shkresë nr. *** prot., datë 23.3.2021, nga AMF-ja; shkresë nr. *** prot., datë 12.3.2021, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; shkresë nr. ***prot., datë 18.3.2021, nga Ministria e Drejtësisë.

rivlerësimit të tij, duke arritur kështu, një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (referuar si “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte, nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar për subjektin e rivlerësimit raportin mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë 27.10.2017, të deklasifikuar me vendimin nr. ***, datë 10.5.2021, të KDZH-së, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar: “Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Abaz Muça”.

Trupi gjykues, në kushtet që pas përditësimit të informacionit në maj të vitit 2021 për subjektin e rivlerësimit, si dhe gjatë hetimit administrativ: (i) nuk evidentoi asnjë informacion apo *indicie* që të implikojë subjektin në kryerjen e ndonjë vepre penale apo cenim të figurës; (ii) nuk rezultuan të dhëna të tjera që të evidentonin se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara, konkludon se subjekti ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, duke arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti²² për vlerësimin e aftësive profesionale është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ky raport ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të të vlerësimit:

- a) aftësive profesionale;
- b) aftësive organizative;
- c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; dhe
- ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit;
- pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- të dhënave nga 23 prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, Drejtorisë së Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënive me Shërbimet Informative dhe Zyra e Informacionit të Klasifikuar, Sektori i Protokoll-Arkivit, si dhe burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënive me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

²² Nr. ***prot., datë 24.2.2020.

Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Detyrat e kryera 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore

Detyra e subjektit të rivlerësimit Abaz Muça, si Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, ka konsistuar kryesisht në drejtimin e kësaj prokurorie në zbatim të nenit 27, të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe Urdhrave nr.147, datë 9.5.2008, “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në prokuroritë e shkallës së parë” dhe nr. 148, datë 9.5.2008, “Për caktimin e shkallës së hierarkisë në prokurori”, të Prokurorit të Përgjithshëm. Gjithashtu, me cilësinë e drejtuesit të institucionit ka kryer edhe funksione administrative që konsistojnë, në mënyrë të përmbledhur, në menaxhimin e burimeve njerëzore (prokurorë, policia gjyqësore, stafi administrativ, marrëdhëniet me institucionet), burimeve financiare, etj.

Rezulton se subjekti i rivlerësimit Abaz Muça, në funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, ka drejtuar dhe kontrolluar hetimin, si dhe ka përfaqësuar akuzën në gjykim për një numër të konsiderueshëm çështjesh penale. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka hetuar 301 çështje gjatë tre viteve të fundit të ushtrimit të detyrës, duke përfunduar gjykimin për 200 çështje penale.

Në lidhje me tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Në këtë pikë do të analizohen tri aktet ligjore, që subjekti i rivlerësimit ka hartuar gjatë ushtrimit të detyrës dhe i ka paraqitur bashkëlidhur formularit të vetëdeklarimit.

1. Konkluzione përfundimtare, të paraqitura para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, për llogari të procedimit penal nr. *, në ngarkim të të pandehurve P.B., L. B. dhe F.C., të akuzuar për veprën penale “vrasje me paramendim” në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 78/2 dhe 25 të Kodit Penal, gjithsej 12 fletë.**

Akti është përpiluar dhe nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, prokurori Abaz Muça, në cilësinë e prokurorit të çështjes.

Nga shqyrtimi i akteve të administruara rezulton se në datën 18.11.2012, para oficerëve të policisë gjyqësore është paraqitur shtetasi L. B., i cili ka kallëzuar faktin e zhdukjes së djalit të tij F.B., duke shpjeguar se kishte dyshime te shtetasit P. B., L. B. dhe F.C. . Dyshimet e kallëzuesit në lidhje me këta persona i referoheshin një debati të zhvilluar disa ditë më parë, me motrat e shtetasve B., që i kanë thënë se djali i tij nuk duhej të ngacmonte kunatën F. B., bashkëshortja e të pandehurit P.B. . Kallëzuesi ka shpjeguar se një kushëri i tij, shtetasi M. B., në datën 18.11.2012, kishte parë tre persona me xhupa dhe kapuç, ku kishte njohur njërin prej tyre, të pandehurin F.C. .

Nga hetimet e kryera ka rezultuar e provuar se në datën 17.11.2012, rreth orës 20:45, në hyrje të qytetit K., para lokalit të të pandehurit P.B., në bashkëpunim me njëri-tjetrin, të pandehurit P. B., i vëllai L.B. dhe F. C., kanë vrarë me sende të forta shtetasin F.B., ndërsa po kalonte para lokalit për të shkuar në banesën e tij. Pas goditjeve në kokë dhe në trup, e kanë futur në bagazhin e automjetit tip “Volvo”, me targa ***, në pronësi të të pandehurit F.C. dhe janë larguar nga territori pranë lokalit. Në automjetin tip “Volvo” kanë qenë të pandehurit F. C. dhe L. B., ndërsa në një tjetër automjet që i ka shoqëruar, tip “Smart”, me targa ***, ka qenë i pandehuri P. B..

Rezulton se dy automjetet, pasi kanë kaluar pikën e karburantit “****”, në rrugë nacionale, kanë devijuar në një rrugë dytësore në drejtim të shtratit të lumit Mat. I pandehuri P. B., nëpërmjet një ekskavatori ka hapur një gropë në të cilën kanë hedhur trupin e viktimës, duke e mbuluar me zhavorr. Sipër grumbullit të zhavorrit kanë lënë një atlete të viktimës që kishte të veshur atë ditë.

Gjatë gjykimit të çështjes janë pyetur disa dëshmitarë okularë, të cilët kanë shpjeguar se kanë parë dy automjetet tip “Volvo” dhe “Smart”, duke ecur me shpejtësi dhe kanë njohur të pandehurin P. B. në drejtimin e automjetit tip “Smart”. Gjithashtu, kanë dëshmuar edhe dëshmitarë të tjerë që kanë dhënë detaje mbi rrethanat e faktit penal, por edhe mbi ngacmimet e viktimës ndaj bashkëshortes së të pandehurit P.B., që kanë nxitur kryerjen e krimit të rëndë të vrasjes.

Gjatë hetimit, i pandehuri L.B. ka shpjeguar në hollësi detajet e ngjarjes, mekanizmin e vrasjes dhe vendin ku ishte propozur viktimja nga ana e tre të pandehurve. Më pas, gjatë gjykimit, të pandehurit kanë mbajtur qëndrime të ndryshme nga sa ishte pranuar gjatë hetimit. I pandehuri L. B. ka pretenduar se vrasja është kryer nga i pandehuri P. B. dhe se ai vetë nuk kishte marrë pjesë në kryerjen e këtij krimi, ndërsa i pandehuri F. C. ka mbajtur qëndrim mohues duke pretenduar se nuk kishte asnjë lidhje me ngjarjen e rëndë.

Prokurori ka pasqyruar në konkluzionet e dhëna para Gjykatës edhe provat e tjera të administruara gjatë hetimit dhe që ishin bërë pjesë e fashikullit gjyqësor, si provat materiale, aktekspertimet, të dhënat e kompanive celulare, etj. Prokurori ka trajtuar në detaje të dhënat e kompanive celulare duke evidentuar komunikimet mes tre të pandehurve ditën e ngjarjes, si një provë e pakundërshtueshme, që në harmoni me provat e tjera të administruara rrëzonin pretendimet e të pandehurve.

Subjekti i rivlerësimit bën një analizë të detajuar të provave të administruara në gjykimin e çështjes, duke analizuar secilën provë në raport me provueshmërinë e faktit penal dhe përgjegjësisë penale të personave të gjykuar, bashkëpunimin mes tyre dhe rolin e secilit prej të pandehurve në realizimin e qëllimit kriminal. Subjekti i rivlerësimit analizon në detaje elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal, duke evidentuar më tej rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe të autorëve, nisur nga motivi i kryerjes së saj dhe mënyra e kryerjes me egërsi e mizori, në lidhje me përcaktimin e masës së dënimit për të pandehurit.

Në përfundim, prokurori subjekt rivlerësimi ka parashtruar para trupit gjykues kërkimet e tij për llojin e masës së dënimit për të tre të pandehurit, provat materiale dhe shpenzimet procedurale.

Konstatohet se akti është përpiluar në përputhje me kriteret ligjore të parashikuara nga neni 378/1 i Kodit të Procedurës Penale.

Ky dokument ligjor rezulton të jetë strukturuar duke ndarë në disa pjesë: (1) pjesa hyrëse; (2) pjesa përshkruese – arsyetuese; (3) pjesa e kërkimit përfundimtar.

Në pjesën hyrëse janë parashtruar gjeneralitetet e tre të pandehurve dhe akuzat në ngarkim të tyre. Pjesa përshkruese – arsyetuese është strukturuar në pjesën e rrethanave të faktit, pjesa e përshkrimit të provave të administruara gjatë gjykimit e paraqitur në mënyrë kronologjike, si dhe pjesa e analizës ligjore. Në pjesën konkluduese të aktit janë pasqyruar kërkimet përfundimtare të prokurorit të çështjes.

Konstatohet se dokumenti ligjor është i strukturuar në paragrafë, gjuha e përdorur është e kuptueshme dhe, përgjithësisht, respektohen rregullat drejtshkrimore. Në arsyetimin e konkluzioneve përfundimtare referohen normat e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale. Në aspektin formal, akti paraqet standarde etike.

Në përfundim të gjykimit, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar para gjykatës:

- Deklarimin fajtor të të pandehurit P.B. për kryerje të veprës penale, të parashikuar nga neni 78/2-25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me burgim të përjetshëm.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit L. B. për kryerje të veprës penale, të parashikuar nga neni 78/2-25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me burgim të përjetshëm.

- Deklarimin fajtor të të pandehurit F.C. për kryerje të veprës penale, të parashikuar nga neni 78/2-25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me burgim të përjetshëm.

Me vendimin nr. ***, datë 19.9.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, ka vendosur:

- Deklarimin fajtor të të pandehurit P.B. për kryerje të veprës penale, të parashikuar nga neni 78/1-25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij 25 vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit L. B. për kryerje të veprës penale, të parashikuar nga neni 78/1-25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 17 vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit F. C. për kryerje të veprës penale, të parashikuar nga neni 78/1-25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 15 vjet burgim.

Me vendimin nr. ***, datë 4.12.2015, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë, me tjetër trup gjykues.

Me vendimin nr. 106, datë 18.5.2016, Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 4.12.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

Me vendimin nr. ***, datë 30.12.2016, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 19.9.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

(Dispozitivi i vendimit është i publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Gjykatës së Lartë).

2. Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. *, në ngarkim të të pandehurit I.D., akuzuar për kryerje të veprës penale “korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.**

Nga aktet rezulton se procedimi penal është regjistruar mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit D. K., banues në K., Burrel, i cili ka shpjeguar se ushtron aktivitet tregtar të përpunimit të mermerit pranë ***dhe se kishte përbushur të gjitha detyrimet ndaj OSHEE-së, në përputhje me kontratën nr***.

Kallëzuesi ka shpjeguar se në ambientet e biznesit të tij kanë vajtur pesë punonjës të OSHEE-së, të cilët janë prezantuar dhe kanë kërkuar të verifikojnë matësin e energjisë elektrike. Gjatë verifikimit, kallëzuesi ka konstatuar se një nga punonjësit ka këputur me pinca dy tela të matësit, ndërsa më pas e kanë kërcënuar se do ta fusnin në burg dhe se duhet të paguante një shumë të konsiderueshme detyrimesh. Një nga punonjësit, i quajtur I., i ka thënë kallëzuesit që të bisedonin privatisht te lokali përballë ambienteve të kantierit. Në bisedë e sipër, punonjësi i OSHEE-së, i pandehuri I.D., i ka kërkuar kallëzuesit shumën 50.000 lekë duke lënë takim për ditën e nesërme.

Kallëzuesi D. K. ka pranuar të bashkëpunojë me oficerët e policisë gjyqësore, duke rënë dakord që të kryhet veprim i simuluar që do të autorizohet nga prokurori, i shoqëruar me përgjim dhe vëzhgim ambjental. Të nesërmen, datë 16.09.2015, rreth orës 09:40, kallëzuesi i ka dhënë shumën 50.000 lekë të pandehurit I. D., veprim i cili është dokumentuar nga oficerët e policisë gjyqësore me mjetet speciale teknike të hetimit. Pas këtij veprimi, oficerët kanë arrestuar në flagrancë të pandehurin I. D., të cilit i janë gjetur paratë në shumën 50.000 lekë, që i kishte marrë nga kallëzuesi D. K. .

Nga tërësia e provave të administruara, prokurori konkludon se ka rezultuar e provuar plotësisht që i pandehuri I. D., në funksion të detyrës si punonjës i OSHEE-së, ka kërkuar dhe ka marrë në mënyrë të paligjshme shumën monetare nga kallëzuesi, duke konsumuar plotësisht elementët e veprës penale “korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

Prokurori, subjekt rivlerësimi Abaz Muça, ka vendosur dërgimin për gjykim të çështjes penale, mbështetur në nenin 331 të Kodit të Procedurës Penale.

Dokumenti ligjor “Kërkesë për gjykim” është i strukturuar në katër pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese – arsyetuese, lista e provave dhe dëshmitarëve, si dhe pjesa konkluduese.

Në pjesën hyrëse prokurori subjekt rivlerësimi përshkruan emërtimin e dokumentit, numrin e procedimit penal, gjeneralitetet e të pandehurit dhe veprën penale në ngarkim të tij.

Në pjesën arsyetuese përshkruan faktin e ndodhur, si dhe provat e aktet që provojnë faktin penal dhe akuzën në ngarkim të të pandehurit. Në pjesën e tretë, prokurori, në mbështetje të nenit 332 të Kodit të Procedurës Penale, ka listuar provat dhe aktet mbi të cilat bazohet akuza e ngritur, si dhe dëshmitarët që vlerëson se duhet të thirren nga gjykata në gjykim, ndërsa në pjesën konkluduese, prokurori parashtron kërkesën e tij.

Nga përmbajtja e dokumentit të mësipërm, konstatohet se përgjithësisht janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, fjalitë paraqiten të qarta, teksti është i kuptueshëm dhe ka strukturë të rregullt. Paragrafët janë të ndarë nga njëri-tjetri dhe arsyetimi është ligjor e logjik, në referencë të normave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

Rezulton se me vendimin nr. ***, datë 9.2.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka vendosur:

- Ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale për të cilën është akuzuar i pandehuri I.D. nga vepra penale “korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, në veprën penale “mashttrim”, të parashikuar nga neni 143/1 i Kodit Penal.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit I. D. për veprën penale “mashttrim”, të parashikuar nga neni 143/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 vit burgim.
- Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale zbritet 1/3 e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 8 muaj burgim.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 31.1.2018, ka vendosur:

- Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 9.2.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, në këtë mënyrë:
- Deklarimin fajtor të të pandehurit I.D. për veprën penale “korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim.
- Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale zbritet 1/3 e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 2 vjet burgim.
- Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim për një periudhë prove 3 vjet.
- Në bazë të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një periudhë 3 vjet.

3. Vendim për shpalljen e moskompetencës për procedimin penal nr. *, akt që është përpiluar dhe nënshkruar nga prokurori Abaz Muça, në cilësinë e prokurorit të çështjes, në datën 16.12.2016.**

Nga shqyrtimi i aktit rezulton se në datën 27.9.2016, në fshatin ***, Njësia Administrative ***, Mat, në vendin e quajtur P. janë konstatuar gjashtë parcela, në të cilat ishin mbjellë rreth 13.360 bimë të dyshuara si bimë narkotike *Cannabis Sativa*.

Pranë parcelave gjendej një banesë dykatëshe, në pronësi të shtetasit B. L., por që administrohej nga shtetasi Sh.L. . Në katin e dytë të banesës, në njërën prej dhomave, është gjetur një sasi prej 80 kg lëndë narkotike në proces tharje, ndërkohë që dhoma ishte parapërgatitur për të tharë lëndën narkotike. Rreth 40 metra pranë banesës është konstatuar një hangar i improvizuar me dru dhe plasmas, ku brenda tij gjendej një sasi prej 3.052 kg lëndë narkotike, e cila ishte në

proces tharjeje. Edhe në ambientin përreth hangarit, rreth 3 metra në pjesën veriore, janë konstatuar mbetje bimësh *Cannabis Sativa*. Pranë hangarit ishte ndërtuar edhe një strukturë tjetër me dru lisi, e pambuluar. Në një distancë rreth 40 metra nga hangari është konstatuar një kamion MAN, me targa ***, në karrocerinë e të cilit u gjetën mbetje bimësh narkotike *Cannabis Sativa*.

Këqyrja e vendit të ngjarjes është pasqyruar në procesverbal edhe me fotografitë e nevojshme, ndërsa janë dërguar për ekspertim kimik disa bimë të sekuestruara në vendngjarje. Eksperti kimist, në aktet nr. ***, datë 18.10.2016, nr. ***, datë 18.10.2016 dhe nr. ***, datë 31.10.2016, ka konkluduar se bimët e sekuestruara janë *Cannabis Sativa*. Ekspertët kriminalistë kanë konkluduar se nuk janë përfutur gjurmë papilare të vlefshme për identifikim.

Prokurori i çështjes ka vendosur të kryejë edhe ekspertim teknik-vlerësues në lidhje me tërësinë e punimeve të kryera, ku është arritur në konkluzion se shumëllojshmëria e punimeve të kryera në fushën e bujqësisë, ndërtimit, punimeve hidraulike, elektrike, transportuese, etj., kërkojnë domosdoshmërisht një numër të caktuar njerëzish të profileve të ndryshme, të cilët kanë punuar për një periudhë disa mujore.

Gjatë hetimit janë administruar edhe deklaratime të personave, të cilët mund të jepnin të dhëna me interes në lidhje me pronësinë dhe administrimin e banesës dhe të tokave, ku u konstatua lëndë narkotike.

Prokurori i çështjes ka analizuar faktet dhe rrethanat e konstatuara gjatë hetimit, duke i parë në këndvështrim të përcaktimeve ligjore të neneve 75/a, 83 e 84 të Kodit të Procedurës Penale. Duke analizuar mënyrën e kryerjes së veprës penale, periudhën kur është kryer, rrethin e personave të përfshirë, vazhdimësinë e aktivitetit dhe qëllimin e përfitimit të të ardhurave materiale, prokurori ka konkluduar se aktiviteti kriminal është kryer në kuadër të një grupi të strukturuar kriminal, i mirëorganizuar dhe i financuar më qëllimin e vetëm të përfitimit material. Për sa më sipër, prokurori vlerëson se nuk ka kompetencë për të vazhduar më tej hetimin e kësaj çështjeje, pasi në rastin konkret kompetencën lëndore e ka Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Me vendimin e datës 14.12.2016, prokurori ka vendosur të shpallë moskompetencën lëndore për kryerjen e hetimeve të procedimit penal nr. ***, duke i dërguar aktet Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Dokumenti ligjor është i strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese – arsyetuese dhe pjesa konkluduese.

Në pjesën hyrëse, prokurori subjekt rivlerësimi, përshkruan subjektin që përpilon aktin, gjeneralitetet e personit të dyshuar dhe veprat penale për të cilat dyshohet se i pandehuri ka kryer.

Në pjesën përshkruese - arsyetuese, fillimisht përshkruhen në mënyrë kronologjike fakti penal i konstatuar, veprimet hetimore të kryera, si dhe provat e aktet që provojnë këtë fakt penal. Më tej, prokurori analizon faktet dhe rrethanat e konstatuara gjatë hetimit dhe në referim të përcaktimeve ligjore të neneve 75/a, 83 e 84 të Kodit të Procedurës Penale konkludon se kompetente për kryerjen e hetimeve është Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për shkak se veprimtaria kriminale është kryer në kuadër të një grupi të strukturuar kriminal. Në pjesën e fundit prokurori parashton vendimmarrjen e tij.

Gjuha e përdorur në akt është e kuptueshme, e qartë dhe në përgjithësi respektohen rregullat drejtshkrimore. Akti është i strukturuar në paragrafë, referohen normat e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale dhe në aspektin formal kërkesa paraqet standarde etike (nga të dhënat e publikuara në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë rezulton se çështja është në proces gjykimi).

Përshkrimi i pesë dosjeve penale të përzgjedhura me short

Dosja nr. 1

Kallëzimi penal nr. ***, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, datë vendimi 17.1.2014.

Rezulton se materiali kallëzues është regjistruar mbi bazën e akteve të referuara nga policia gjyqësore e Komisarariatit të Policisë Mat, në lidhje me ngjarjen e datës 28.12.2013, ku në fshatin ***, Komuna ***, Mat, janë djegur kasollja dhe magazina e shtetasve N. dhe S.Ll. . Nga këqyrja e vendit të ngjarjes ka rezultuar se magazina është djegur plotësisht nga zjarri, ndërsa kasollja pjesërisht. Personat që kanë qenë të pranishëm në vendngjarje kanë dhënë deklarime duke sqaruar rrethanat e faktit. Sipas deklarimeve të administruara në fashikull, rezulton se është konstatuar zjarri që ka rënë brenda në magazinë dhe më pas ka vazhduar edhe në kasollen e bagëtive që ndodhet ngjitur me magazinën. Deklaruesit shpjegojnë se rrjeti elektrik ishte shumë i amortizuar, duke përfshirë mundësinë e një zjarrvënijeje të qëllimshme, pasi shpjegojnë se nuk kanë asnjë konflikt me persona të tjerë.

Në fashikull është administruar raporti i specialistëve të PMNZSH-së Mat dhe relacioni teknik i specialistëve të CEZ Shpërndarje sh.a. Specialistët e fushës konkludojnë se shkaku i rënies së zjarrit ka qenë ndonjë shkëndijë elektrike nga rrjeti tejet i amortizuar elektrik brenda magazinës.

Në analizë të provave shkresore të administruara në fashikullin e kallëzimit penal, prokurori ka konkluduar se djegia e objekteve ka qenë aksidentale dhe jo e shkaktuar nga faktorë kriminalë, duke vendosur mosfillimin e procedimit penal në datën 17.1.2014.

Rezulton se vendimi i mosfillimit të procedimit penal i është njoftuar të dëmtuarit N.Ll. nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr. ***, datë 20.1.2014. Nga aktet e dërguara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat nuk rezulton që ky vendim të jetë ankimuar.

Dokumenti ligjor “vendim mosfillimi” është i strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkuese-arsyetuese dhe dispozitivi.

Në pjesën hyrëse, prokurori subjekt rivlerësimi, përshkruan subjektin vendimmarrës, emërtimin e këtij dokumenti, datën dhe ngjarjen së cilës i referohen aktet.

Në pjesën përshkuese-arsyetuese, fillimisht, përshkruhet fakti penal i referuar dhe mënyra e njoftimit, konkretisht nga policia gjyqësore e Komisarariatit të Policisë Mat. Më tej përshkruhen të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit. Në fund analizohet mungesa e veprës penale për shkak se pasoja e ardhur është aksidentale për shkak të rrjetit të amortizuar dhe jo nga faktorë kriminalë. Në pjesën e dispozitivit prokurori përshkruan vendimmarrjen e tij.

Nga përmbajtja e dokumentit të mësipërm konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, fjalitë paraqiten të qarta dhe teksti i kuptueshëm. Dokumenti paraqitet i strukturuar në mënyrë të rregullt, paragrafët janë të ndarë nga njëri-tjetri, në arsyetimin e vendimit referohen normat e Kodit të Procedurës Penale ku mbështetet vendimi.

Dosja nr. 2

Procedimi penal nr. *** i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, datë regjistrimi 6.6.2014, regjistruar për veprën penale “përdorim me keqdashje i thirrjeve telefonike”, parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal.

Dokumenti ligjor “vendim për pushimin e procedimit penal”, datë 1.9.2014.

Ky procedim penal është regjistruar mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit M. B., banues në K., Mat. Kallëzuesi ka shpjeguar se përdor numrin celular *** të kompanisë ***, tek i cili i kanë ardhur disa thirrje telefonike nga një numër i fshehur. Nga ky numër i fshehur, në datën

2.6.2014, ora 18:58 dhe në datën 3.6.2014, ora 22:59, ka komunikuar një person i seksit mashkull që i ka thënë: “... edhe ti do të pësosh fatin e tjetrit ...”.

Pas regjistrimit të procedimit penal, me qëllim të identifikimit të numrit telefonik dhe personit që ka kryer thirrjet telefonike, është kërkuar informacioni i nevojshëm nga kompania celulare *** sh.a. Nga të dhënat e administruara ka rezultuar se numri telefonik nga i cili janë kryer telefonatat ishte ***, i regjistruar në emër të shtetasit A. M. .

Shtetasi M. B., në datën 21.8.2014, ka deklaruar para oficerëve të policisë gjyqësore se dëshiron të heqë dorë nga ankimi dhe se nuk do që të ndiqet penalisht fakti i kallëzuar prej tij.

Prokurori Abaz Muça ka analizuar përcaktimet ligjore të neneve 284 dhe 286 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet që ndjekja penale për disa vepra penale, ndër to edhe ajo e parashikuar nga neni 257 i Kodit Penal, mund të fillojë vetëm me ankimin e të dëmtuarit nga kjo vepër penale, i cili mund ta tërheqë ankimin në çdo fazë të procedimit.

Në rrethanat kur shtetasi M.B. ka deklaruar se tërheq ankimin e tij, prokurori, në mbështetje të germës “c”, të nenit 328/1, të Kodit të Procedurës Penale, në datën 1.9.2014, ka vendosur të pushojë hetimet e procedimit penal nr. **, duke u shprehur edhe për provat materiale të sekuestruara dhe shpenzimet procedurale, sipas kërkesave të nenit 286/3 të Kodit të Procedurës Penale.

Nga aktet e fashikullit nuk rezulton që ndaj këtij vendimi të jetë ushtruar ankim.

Dokumenti ligjor “vendim pushimi” është i strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese - arsyetuese dhe dispozitivi.

Në pjesën hyrëse, subjekti i rivlerësimit, prokurori Abaz Muça, përshkruan subjektin vendimmarrës, numrin e procedimit penal dhe veprën penale për të cilën është regjistruar.

Në pjesën përshkruese - arsyetuese, fillimisht, përshkruhen rrethanat e përshkruara nga ankuesi mbi bazën e të cilave është regjistruar procedimi penal. Më tej përshkruhen veprimet hetimore të kryera në kuadër të këtij procedimi. Në mbyllje bëhet analiza ligjore në referencë të dispozitave ligjore të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, duke konkluduar se hetimet e kësaj çështjeje penale duhet të pushohen. Në pjesën konkluduese parashtron disponimin e tij.

Nga përmbajtja e dokumentit të mësipërm konstatohet se paraqitet i strukturuar dhe i arsyetuar, janë respektuar rregullat e drejtshkkrimit, fjalitë janë të qarta. Dokumenti paraqitet i strukturuar në mënyrë të rregullt, paragrafët janë të ndarë nga njëri-tjetri, teksti është i qartë dhe vendimi është i analizuar drejt. Në arsyetimin e vendimit referohen normat e Kodit Penal, si dhe të Kodit të Procedurës Penale. Nga pikëpamja e formës, renditja e akteve procedurale pasqyron administrim të rregullt të dosjes.

Dosja nr. 3

Procedimi penal nr. **i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, datë regjistrimi 28.6.2016, regjistruar për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal.

Dokumenti ligjor “vendim për pushimin e procedimit penal”, datë 21.7.2016.

Nga studimi i akteve të këtij procedimi penal rezulton se shtetasi H.T., banues në K., Mat, ka depozituar kallëzim penal para oficerëve të policisë gjyqësore, duke shpjeguar se në datën 15.6.2016 është konfliktuar fizikisht me shtetasin M. Ç., për shkaqe banale, në pije e sipër. Pas konfliktit, të dy shtetasit kanë shkuar në spitalin rajonal të Burrelit dhe më pas në banesat e tyre. Rezulton se edhe shtetasi M.Ç. e ka paraqitur ankimin para oficerëve të policisë në Komisariatin e Policisë Mat, në lidhje me këtë konflikt.

Mjeku ligjor, në aktekspertimin nr. ***, datë 16.6.2016, ka konkluduar se te shtetasi M.Ç. konstatohen dëmtime në kokë, të kategorizuara në humbje të aftësisë së përkohshme në punë në masën mbi 9 ditë (plagosje e lehtë).

Mjeku ligjor, në aktekspertimin nr. ***, datë 16.6.2016, ka konkluduar se te shtetasi H. T. konstatohen dëmtime në kokë, të kategorizuara në humbje të aftësisë së përkohshme në punë në masën deri në 9 ditë (rrahje).

Rezulton se në datën 19.6.2016 të dy shtetasit e përfshirë në konflikt kanë tërhequr ankimin e paraqitur ndaj njëri-tjetrit, duke deklaruar se nuk kërkojnë të kryhet ndjekje penale në lidhje me ngjarjen e datës 16.6.2016.

Prokurori Abaz Muça ka analizuar përcaktimet ligjore të neneve 284 dhe 286 të Kodit të Procedurës Penale, i cili ka parashikuar që ndjekja penale për disa vepra penale, ndër to edhe ajo e parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, mund të fillojë vetëm me ankimin e të dëmtuarit nga kjo vepër penale, i cili mund ta tërheqë ankimin në çdo fazë të procedimit. Në rrethanat kur shtetasi i dëmtuar M. Ç. ka deklaruar se tërheq ankimin e tij, prokurori, në mbështetje të germës “c”, të nenit 328/1, të Kodit të Procedurës Penale, më 21.7.2016, ka vendosur të pushojë hetimet e procedimit penal nr. ***, duke u shprehur edhe për shpenzimet procedurale sipas kërkesave të nenit 286/3 të Kodit të Procedurës Penale.

Nga aktet e fashikullit nuk rezulton që ndaj këtij vendimi të jetë ushtruar ankim.

Dokumenti ligjor “vendim pushimi” është i strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkuese - arsyetuese dhe dispozitivi.

Në pjesën hyrëse, subjekti i rivlerësimit, prokurori Abaz Muça, përshkruan subjektin vendimmarrës, numrin e procedimit penal dhe veprën penale për të cilën është regjistruar.

Në pjesën përshkuese - arsyetuese, fillimisht, përshkruhen rrethanat e përshkruara nga ankuesi mbi bazën e të cilave është regjistruar procedimi penal. Më tej përshkruhen veprimet hetimore të kryera në kuadër të këtij procedimi. Në mbyllje bëhet analiza ligjore në referencë të dispozitave ligjore të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, duke konkluduar se hetimet e kësaj çështjeje penale duhet të pushohen. Në pjesën konkluduese parashtron disponimin e tij.

Nga përmbajtja e dokumentit të mësipërm konstatohet se paraqitet i strukturuar dhe i arsyetuar, janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, si dhe fjalitë janë të qarta. Dokumenti paraqitet i strukturuar në mënyrë të rregullt, paragrafët janë të ndarë nga njëri-tjetri, teksti është i qartë dhe vendimi është i analizuar drejt. Në arsyetimin e vendimit referohen normat e Kodit Penal, si dhe të Kodit të Procedurës Penale. Nga pikëpamja e formës, renditja e akteve procedurale pasqyron administrim të rregullt të dosjes.

Dosja nr. 4

Procedimi penal nr***, me datë regjistrimi 28.5.2015, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, regjistruar për veprën penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, mbetur në tentativë dhe “mbajtje pa leje e armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 79/dh e 22, 278/5 të Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurit E. S. .

Dokumenti ligjor “kërkesë për gjykimin e çështjes penale”.

Nga aktet rezulton se në datën 27.5.2015, rreth orës 15:40, salla operative e Komisarariatit të Policisë Mat ka marrë njoftim për një ngjarje në komunën ***, Mat, ku janë plagosur me armë zjarri shtetasit L.P. dhe V.T. . Janë kryer veprimet e para hetimore në vendngjarje, këqyrje, sekuestrime të provave materiale dhe pyetja e personave që kanë dijeni për rrethanat e konfliktit. Oficerët e policisë gjyqësore kanë sekuestruar automjetin tip “Opel”, me targa ***, në pronësi të shtetasit të dëmtuar L. P. dhe në një distancë rreth 300 metra nga vendi i ngjarjes

kanë gjetur e sekuestruar një automjet tip “Mitsubish”, me targa ***, që në momentin e konfliktit përdorej nga i pandehuri E.S. .

Shtetasi L.P., banues në ***, Pukë, ka deklaruar se konflikti me të pandehurin E.S. ka lindur në lidhje me të fejuarën e tij N. C., të cilën e ngacmonte i pandehuri. Për të sqaruar situatën, kishte ardhur së bashku me një shok, shtetasin V. T., banues në Tiranë. Deklaruesi ka shpjeguar se në debat e sipër, i pandehuri E.S. ka qëlluar disa herë me armë zjarri, pistoletë, në drejtim të tij dhe më pas edhe në drejtim të shokut të tij që ka dalë nga automjeti për ta ndihmuar. Shpjegime të hollësishme rreth ngjarjes ka dhënë edhe shtetasi V. T. .

Shpjegime të hollësishme ka dhënë gjithashtu edhe shtetasja N. C., e cila ka sqaruar marrëdhëniet e bashkëjetesës me shtetasin L.P., por edhe ngacmimet e vazhdueshme nga i pandehuri E. S., me të cilin ka pasur marrëdhënie më parë, gjatë periudhës së shkollës së mesme dhe të lartë. Në lidhje me rrethanat e faktit janë administruar edhe deklaratimet e shtetasve A. R., V. D., L.D., V. Ç., A.S., S.Ç., D. Ç., S. B. dhe H.C. .

Eksperti mjeko-ligjor, në aktekspertimin nr. ***, datë 2.6.2015, ka konkluduar se dëmtimet e shtetasit L.P. (plagë arme zjarri në hapësirën ndërbrinjore të tretë, grumbullim gjaku dhe ajri në kavitetin e djathtë të kraharorit, thyerje e brinjës së tetë të djathtë dhe shpatullës së djathtë) hyjnë në kategorinë e dëmtimeve të rënda, pasi kanë qenë të rrezikshme për jetën në çastin e shkaktimit të tyre.

Eksperti mjeko-ligjor, në aktekspertimin nr. ***, datë 2.6.2015, ka konkluduar se dëmtimet e shtetasit V. T. (plagë arme zjarri në bark, me vrimë hyrje në pjesën e parme dhe ngelur në pjesën e pasme të legenit, rupturë e zorrëve të holla dhe pjesës zbritëse të zorrës së trashë, grumbullim gjaku në hapësirën e barkut) hyjnë në kategorinë e dëmtimeve të rënda, pasi kanë qenë të rrezikshme për jetën në çastin e shkaktimit të tyre.

Nga tërësia e provave të administruara, prokurori konkludon se ka rezultuar e provuar plotësisht që i pandehuri E. S., në kushtet e gjaknxehtësisë së krijuar nga debati me shtetasin L. P. në lidhje me shtetasen N. C., ka qëlluar me armë zjarri pistoletë në drejtim të tij e më pas edhe në drejtim të shtetasit V. T. . Prokurori arsyeton se mendimi kriminal i të pandehurit E. S. për eliminimin fizik të tyre ka lindur gjatë debatit që po zhvillohej me shtetasin L. P., i cili u agravua nga debat verbal në debat fizik e më pas në përdorimin e armës së zjarrit. Prokurori bën një analizë ligjore edhe për fazën e tentativës, në të cilën ka mbetur kryerja e veprës penale për rrethana të pavarura nga vullneti i të pandehurit, i cili e ka dëshiruar ardhjen e pasojës.

Prokurori subjekt rivlerësimi, Abaz Muça, në datën 15.7.2015, ka vendosur dërgimin për gjykim të çështjes penale, mbështetur në nenin 331 të Kodit të Procedurës Penale.

Dokumenti ligjor “Kërkesë për gjykim” është i strukturuar në katër pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese – arsyetuese, lista e provave dhe dëshmitarëve, si dhe pjesa konkluduese.

Në pjesën hyrëse, prokurori, subjekt rivlerësimi përshkruan emërtimin e dokumentit, numrin e procedimit penal, gjeneralitetet e të pandehurit dhe veprat penale në ngarkim të tij.

Në pjesën arsyetuese përshkruan faktin e ndodhur, si dhe provat e aktet që provojnë faktin penal dhe akuzën në ngarkim të të pandehurit. Në pjesën e tretë, prokurori, në mbështetje të nenit 332 të Kodit të Procedurës Penale, ka listuar provat dhe aktet mbi të cilat bazohet akuza e ngritur, si dhe dëshmitarët që vlerëson se duhet të thirren nga Gjykata në gjykim, ndërsa në pjesën e katërt, atë konkluduese, parashtron kërkesën e tij.

Nga përmbajtja e dokumentit të mësipërm konstatohet se përgjithësisht janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, fjalitë paraqiten të qarta, teksti është i kuptueshëm dhe ka strukturë të rregullt. Paragrafët janë të ndarë nga njëri-tjetri dhe arsyetimi është ligjor e logjik, në referencë të normave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

Rezulton se me vendimin nr. ***datë 14.6.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka vendosur:

- Ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës penale për të pandehurin E. S. nga “vrasje në rrethana cilësuese”, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 78/dh–22 të Kodit Penal, në dëm të shtetasit L. P., në veprën penale “vrasje e kryer në kushtet e tronditjes së fortë psikike”, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 82-22 të Kodit Penal, deklarin e tij fajtor dhe dënimin me 4 vjet burgim.
- Ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës penale për të pandehurin E.S. nga “vrasje në rrethana cilësuese”, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 79/dh-22 të Kodit Penal, në dëm të shtetasit V.T., në veprën penale “vrasje e kryer në kushtet e tronditjes së fortë psikike”, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 82-22 të Kodit Penal, deklarin e tij fajtor dhe dënimin me 4 vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit E.S. për kryerjen e veprës penale “mbajtje pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim.
- Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal vendos dënimin e tij përfundimisht me 7 vjet burgim.

Ky vendim është ankimuar si nga prokurori i çështjes ashtu edhe nga i pandehuri. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr***, datë 23.4.2018, ka vendosur:

- Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 14.6.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit E. S. për kryerjen e veprës penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, mbetur në tentativë të parashikuar nga nenet 79/dh e 22 të Kodit Penal dhe bazuar në këtë dispozitë dënimin e tij me 22 vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit E. S. për kryerjen e veprës penale “mbajtje pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim.
- Në mbështetje të nenit 55 të Kodit Penal për bashkimin e dënimeve, dënimin e të pandehurit E. S. me një dënim të vetëm prej 24 vjet burgim.

Dosja nr. 5

Procedimi penal nr***, datë regjistrimi 4.9.2015, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, regjistruar për veprën penale “vjedhje e energjisë elektrike”, parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurit Q. Ll. .

Dokumenti ligjor “kërkesë për gjykimin e çështjes penale”.

Nga aktet rezulton se në datën 26.8.2015, punonjësit e OSHEE-së, dega Mat, kanë konstatuar në banesën e të pandehurit në fshatin ***, Mat, se ishte kryer një lidhje elektrike jashtë matësit të energjisë elektrike. Konkretisht, i pandehuri Q. Ll. kishte vendosur një përcjellës rreth 40 metra nga linja e tensionit të ulët deri te pompa e ujit. Oficerët e policisë gjyqësore kanë realizuar këqyrjen e vendit të ngjarjes, kanë sekuestruar provat materiale dhe kanë marrë deklarime nga punonjësit e OSHEE-së, si dhe nga vetë i pandehuri i cili ka pranuar faktin penal, duke shpjeguar se e ka kryer për shkak të debive që kishte ndaj OSHEE-së dhe gjendjes së vështirë ekonomike në familje.

Nga tërësia e provave të administruara, prokurori konkludon se ka rezultuar e provuar plotësisht që i pandehuri Q. Ll., nëpërmjet ndërhyrjes së paligjshme në rrjetin e energjisë elektrike, ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, duke bërë një analizë të detajuar të elementëve të kësaj veprë penale.

Prokurori, subjekt rivlerësimi Abaz Muça, më 16.10.2015, ka vendosur dërgimin për gjykim të çështjes penale, mbështetur në nenin 331 të Kodit të Procedurës Penale.

Dokumenti ligjor “kërkesë për gjykim” është i strukturuar në katër pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkuese – arsyetuese, lista e provave dhe dëshmitarëve, si dhe pjesa konkluduese.

Në pjesën hyrëse, prokurori subjekt rivlerësimi përshkruan emërtimin e dokumentit, numrin e procedimit penal, gjeneralitetet e të pandehurit dhe veprën penale në ngarkim të tij.

Në pjesën arsyetuese, përshkruan faktin e ndodhur si dhe provat e aktet që provojnë faktin penal dhe akuzën në ngarkim të të pandehurit. Në pjesën e tretë, prokurori, në mbështetje të nenit 332 të Kodit të Procedurës Penale, ka listuar provat dhe aktet mbi të cilat bazohet akuza e ngritur, si dhe dëshmitarët që vlerëson se duhet të thirren nga gjykata në gjykim, ndërsa në pjesën e katërt, atë konkluduese, parashtron kërkesën e tij.

Nga përmbajtja e dokumentit të mësipërm konstatohet se, përgjithësisht, janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, fjalitë paraqiten të qarta, teksti është i kuptueshëm dhe ka strukturë të rregullt. Paragrafët janë të ndarë nga njëri-tjetri dhe arsyetimi është ligjor e logjik, në referencë të normave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

Rezulton se me vendimin nr. ***, datë 9.12.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka vendosur:

- Deklarimin fajtor të të pandehurit Q. Ll. për kryerjen e veprës penale “vjedhje e energjisë elektrike”, parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 muaj burgim.
- Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale zbritjen e 1/3 së dënimit duke u dënuar përfundimisht me 3 muaj burgim.

Të dhënat arkivore (ankesat dhe masat disiplinore - vlerësimet)

1. Nga verifikimi në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme rezulton që ndaj subjektit të rivlerësimit Abaz Muça nuk janë marrë masa disiplinore.

2. Mbi bazën e kërkesës për informacion, dërguar nga Komisioni, i është kërkuar informacion strukturave përkatëse të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të gjitha prokurorive pranë gjykatës së shkallës së parë. Në përgjigje të shkresave është administruar si vijon:

2.1 Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin është regjistruar materiali kallëzues nr. ***, viti 2017, për veprën penale “shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Rezulton se me shkresën nr. ***, datë 7.9.2017, Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin kallëzimin e shtetasit B. R. ndaj prokurorit Abaz Muça. Kallëzuesi B.R., i cili ushtron funksionin e avokatit, ka shpjeguar se ka përfaqësuar të drejtat e të dënuarit H. P. në procesin gjyqësor në fazën e ekzekutimit të vuajtjes së dënimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat. Kallëzuesi shpjegon se në datën 28.6.2017 është zhvilluar seanca gjyqësore me objekt kërkesë “lirim para kohe me kusht” në prani të të dënuarit, avokates së zyrës E. H., prokurorit Abaz Muça, gjyqtarit M.Ll. dhe familjarëve të të dënuarit. Kallëzuesi pretendon se prokurori, gjatë zhvillimit të seancës, ka mbajtur qëndrim në shkelje të etikës dhe në abuzim të hapur me detyrën, duke hedhur baltë mbi kallëzuesin dhe zyrën e avokatisë. Në përfundim të seancës, sipas pretendimeve të kallëzuesit, prokurori i ka thënë avokates: “*Mos u mërzit se nuk e kisha me ju personalisht, por me drejtuesin e studios tënde ...*”. Kallëzuesi shpjegon se prokurori u ka thënë familjarëve të të dënuarit se “*... nëse nuk do të kishe pasur avokat B. R., unë do ta liroja babain tënd, madje personin që më ka hyrë mik e kam për zemër, por keni atë avokat dhe do ta lë në burg, nuk do t’i jap kushtin, këtë ia kam thënë edhe gjyqtarit se e kam mik ...*”. Kallëzuesi pretendon se kjo sjellje ka agravuar marrëdhëniet e avokatit me familjarët e të dënuarit, duke vënë në rrezik edhe jetën e tij.

Pas regjistrimit të materialit kallëzues nr. *** në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, i kallëzuari, prokurori Abaz Muça ka dhënë shpjegime në lidhje me gjithë procesin gjyqësor të ndjekur, i cili vazhdonte akoma pa u marrë vendimi gjyqësor i formës së prerë. Prokurori Abaz Muça ka shpjeguar se ka mbajtur qëndrim ligjor në gjykim dhe se nuk ka asnjë konflikt me avokatët. Janë marrë shpjegime edhe nga djali i të dënuarit, i cili ka mohuar pretendimet e kallëzuesit për deklaratat e prokurorit në lidhje me të.

Nga administrimi i CD-ve të seancave gjyqësore nuk kanë rezultuar të dhëna që të provojnë pretendimet e kallëzuesit, për sa i përket sjelljes së prokurorit në seancë gjyqësore.

Prokurori i çështjes, pas verifikimeve paraprake, ka konkluduar se nuk rezultojnë fakte apo prova që të mbështesin apo konfirmojnë pretendimet e kallëzuesit. Nga të dhënat e administruara, në përfaqësimin e çështjes nga prokurori, nuk rezultojnë elementë të ndonjë vepre penale duke konkluduar se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Në datën 25.9.2017 është vendosur mosfillimi i procedimit penal, bazuar në nenet 290/1, (ç) e 291 të Kodit të Procedurës Penale. Vendimi i mosfillimit u është njoftuar palëve.

Subjekti i rivlerësimit, pas kërkesës së Komisionit për të qartësuar statusin aktual të kësaj çështjeje, ka shpjeguar se ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal datë 13.1.2017 nuk është ushtruar ankim duke i dokumentuar ato me vërtetimin nr. *** prot., datë 14.6.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe me vendimin për mosfillimin e procedimit penal të materialit kallëzues nr. ***, të vitit 2015, disponuar nga subjekti i rivlerësimit, prokurorja A.P. .

2.2 Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë është regjistruar materiali kallëzues nr. ***, viti 2016, mbi bazën e akteve të dërguara për zgjidhje ligjore nga Drejtoria Task-Forcë, në Prokurorinë e Përgjithshme. Konstatohet se shtetasi I. M. ka pretenduar se kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, A.Ç., dhe Drejtuesi i Prokurorisë, Abaz Muça, kanë falsifikuar dokumentet e pronësisë së një sipërfaqeje toke në emër të shtetasit P. M. .

Gjatë verifikimeve paraprake djali i kallëzuesit ka dhënë shpjegime për shkak të moshës 81-vjeçare dhe gjendjes shëndetësore të kallëzuesit. Është sqaruar fakti se bëhej fjalë për një sipërfaqe toke prej 2.600 m² që shtetasi I.M. ia kishte blerë nëpërmjet një deklaratë dore, jo noteriale, shtetasit P.M. . Ka rezultuar më pas se shtetasi P.M. kishte regjistruar në ZVRPP-në Mat një sipërfaqe prej 4.000 m², duke përfshirë edhe sipërfaqen e shitur e duke i kërkuar që t'i blinin edhe pjesën prej 1.400 m² dhe t'i pajiste me certifikatë pronësie për gjithë sipërfaqen. Në lidhje me këtë situatë, shtetasi I.M. ishte ankuar edhe më parë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, ku rezulton se ka qenë regjistruar kallëzimi penal nr. ***, i cili është mosfilluar me vendimin e datës 11.5.2015, me arsyetimin se konflikti i pronësisë duhet të trajtohej si një konflikt civil, pasi nuk ishin konstatuar elementë të ndonjë vepre penale. Shtetasi I. M. është ankuar edhe në vitin 2016, ankesë e cila është verifikuar dhe i është kthyer përgjigje me shkresën nr. ***, datë 1.7.2016.

Prokurori që ka trajtuar materialin kallëzues ka konkluduar se fakti i kallëzuar nuk përmban elemente të figurës së veprave penale të parashikuara nga nenet 186 apo 248 të Kodit Penal. Edhe nga provat e administruara në fashikullin e kallëzimit penal nuk rezultojnë elemente të ndonjë vepre penale në veprimtarinë e drejtuesve të Gjykatës apo Prokurorisë Mat. Me arsyetimin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, bazuar në nenet 290/1, (ç) e 291 të Kodit të Procedurës Penale, në datën 13.1.2017, është vendosur mosfillimi i procedimit penal, i cili u është njoftuar palëve.

Subjekti i rivlerësimit, pas kërkesës së Komisionit për të qartësuar statusin aktual të kësaj çështjeje, ka dhënë shpjegime të detajuara mbi kronologjinë e kësaj çështjeje, si dhe ka parashtruar se ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal, datë 13.1.2017, nuk është ushtruar ankim duke i dokumentuar me vërtetimin nr*** prot., datë 14.6.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

2.3 Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda është regjistruar materiali kallëzues nr. ***, mbi bazën e akteve të dërguara për kompetencë nga Drejtoria Task-Forcë në Prokurorinë e Përgjithshme. Rezulton se ndaj prokurorit Abaz Muça janë depozituar dy ankesa të shtetasve V.K. dhe I.F. .

Në letëranksën e shtetasit V.K. pasqyrohet fakti se ky shtetas e ka ndihmuar kallëzuesin në një çështje, ku ai ka qenë i akuzuar për mbajtje pa leje të armëve luftarake, në këmbim të shumave monetare. Gjithashtu, pasqyron edhe raste të tjera ku ka qenë në rolin e sekserit dhe se arsyeja që ankohet është sepse në qytet e quajnë “spiuni i Abazit” dhe i kanë thënë të largohet nga qyteti.

Gjatë verifikimeve paraprake, shtetasi V.K. është thirrur për të dhënë shpjegime, i cili ka deklaruar se nuk ka paraqitur asnjë ankesë dhe se nënshkrimi në letëranksë nuk është hedhur prej tij. Ky shtetas ka deklaruar se është dënuar për “mbajtje pa leje të armëve luftarake” në vitin 1997, por prokuror i çështjes ka qenë z. I.Ç. .

Shtetasi I. F., në ankesën e tij, pretendon se prokurori Abaz Muça i ka shkuar në burgun e Burrelit dhe i ka bërë presion që të tërhiqet nga kërkesat e tij me argumentin se vetëm kur të donte prokurori, mund të lirohej. Gjithashtu, ankuesi pasqyron edhe raste të tjera ku të dënuarit kanë fituar lirinë kundrejt parave për pranimin e kërkesave të tyre.

Për të sqaruar të dhënat e trajtuara në ankesë është pyetur në burgun e Burrelit i dënuari I. F., i cili ka deklaruar se nuk ka paraqitur asnjë ankesë ndaj prokurorit Abaz Muça dhe se nuk di të shkruajë në kompjuter. Personat e përmendur në ankesë i njëjti pasi vuajnë dënimin në burgun e Burrelit, por nuk e ka idenë se cili prokuror ka qenë në çështjet e tyre.

Prokurori i çështjes, pas verifikimeve paraprake, pas verifikimit të pretendimeve të ngritura nga persona të tjerë të panjohur, në emër të dy ankuesve, konkludon se nuk janë konstatuar elementë të ndonjë vepre penale. Me argumentimin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, bazuar në nenet 290/1, (ç) e 291 të Kodit të Procedurës Penale, në datën 8.10.2015, është vendosur mosfillimi i procedimit penal.

Subjekti i rivlerësimit, pas kërkesës së Komisionit për të qartësuar statusin aktual të kësaj çështjeje, ka shpjeguar se: (i) në vitin 1997 nuk ka pasur statusin e prokurorit, por ka qenë student ende pa mbaruar studimet në arsimin e lartë, si dhe shtetasi I.F., i dënuar me 25 vjet burgim, nuk ka bërë kërkesë për lirim me kusht; (ii) në lidhje me letrat/ankesat shtetasi V.K. ka deklaruar se nuk ka paraqitur asnjë ankesë dhe se nënshkrimi në letëranksë nuk është hedhur prej tij. Ky shtetas ka deklaruar se është dënuar për “mbajtje pa leje të armëve luftarake” në vitin 1997, por prokuror i çështjes ka qenë z. I. Ç.; (iii) shtetasi I.F. ka deklaruar se nuk ka paraqitur asnjë ankesë ndaj prokurorit Abaz Muça dhe se nuk di të shkruajë në kompjuter; (iv) në lidhje me këto letra/ankesa ka parashtruar se janë kryer nga persona që punojnë në organet e drejtësisë dhe me dashje kanë dashur të hedhin baltë mbi personalitetin e tij, për shkak të kërkesës së llogarisë që ka kërkuar, në funksion të veprimtarisë ligjore dhe kushtetuese për të rritur besimin e publikut në luftën kundër korrupsionit dhe krimit, si dhe performancën dhe cilësinë e hetimeve në institucionin që ushtronte detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë; (v) ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal datë 8.10.2015 nuk është ushtruar ankim duke e dokumentuar me vërtetimin nr***prot., datë 14.6.2021, të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë.

2.4. Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda është regjistruar procedimi penal nr. ***, për veprat penale “korrupsion aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, “korrupsion pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë” dhe “ushtrim i ndikimit të paligjshëm”, të parashikuara nga nenet 319, 319/ç dhe 245 të Kodit Penal. Me shkresën nr. ***, datë 19.3.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka konfirmuar se çështja penale është ende në hetim, pa emra personash të regjistruar në regjistër.

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me shkresën nr. ***, datë 16.1.2020, ka konfirmuar se Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda (emërtimi në periudhën e shqyrtimit të kërkesës së prokurorit) me vendimin nr. ***, datë 15.7.2019, ka miratuar kërkesën për pushimin e hetimeve.

Nga të dhënat e pasqyruara në vendim ka rezultuar se Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka dërguar një informacion pranë Prokurorisë për Krime të Rënda, ku dyshohej që mund të kryheshin veprime korruptive të gjyqtarit dhe prokurorit, për lirimin me kusht të një të dënuari. Kishte dyshime se shtetasi G.C. kishte vënë në dispozicion shumën prej 60.000 euro me qëllim pranimin e kërkesës së të dënuarit K. N., për lirimin para kohe me kusht. Ka rezultuar se gjyqtari i çështjes ishte A. K. ndërsa prokuror Abaz Muça. Nga hetimet e zhvilluara ka rezultuar se prokurori Abaz Muça ka kundërshtuar në seancë lirimin e të dënuarit, duke argumentuar se nuk përmbusheshin kriteret ligjore të parashikuara në nenin 64 të Kodit Penal. Edhe nga hetimet e kryera të karakterit teknik, si vëzhgime ambientale dhe përgjime telefonike, nuk kanë rezultuar prova për të provuar ekzistencën e faktit penal të dyshuar. Në datën 12.6.2019, prokurori i çështjes ka dërguar në gjykatë kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. ***. Me vendimin gjyqësor nr***, datë 15.7.2019, është miratuar kërkesa e prokurorit për pushimin e hetimeve të këtij procedimi penal.

2.5 Në Prokurorinë e Përgjithshme është regjistruar praktika nr. *** mbi bazën e ankesës së shtetases Sh. Xh., banuese në ***, Burrel. Ankuesja shpjegon se automjeti me targa ***, në pronësi të djalit të saj, është sekuestruar si provë materiale nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Mat, pasi në drejtim të këtij automjeti është qëlluar më armë automatike. Ankuesja kërkon kthimin e automjetit të sekuestruar, duke shpjeguar se me shkresën nr. ***, datë 19.2.2015, i është kthyer përgjigje nga prokurori i çështjes L.F., i cili ka vendosur se automjeti nuk do të kthehej pasi dëmtohej hetimi.

Me shkresën nr***, datë 22.12.2016, drejtori i Drejtorisë së Hetimit në Prokurorinë e Përgjithshme ka informuar ankuesen Sh.Xh. se në bazë të nenit 462 të Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, nuk mund të ekzekutohet vendimi mbi provën materiale, pasi çështja është ende në gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

2.6 Në Prokurorinë e Përgjithshme është regjistruar praktika nr. *** mbi bazën e ankesës së shtetasit V.K., banues në ***, Mat, ardhur për kompetencë nga Kryeministria. Ankuesi V.K. shpjegon se i ka dhënë shuma monetare prokurorit Abaz Muça për një çështje në ngarkim të tij për “mbajtje pa leje të armëve luftarake”. Gjithashtu, pretendon se ka kryer rolin e sekserit edhe në raste të tjera.

Me shkresën nr. ***, datë 22.5.2015, drejtori i Drejtorisë Task-Forcë në Prokurorinë e Përgjithshme ka dërguar ankesën në Prokurorinë pranë Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë. Pas verifikimeve të kryera është vendosur mosfillimi i procedimit penal në datën 8.10.2015. (trajtuar më lart në pikën 2.3).

2.7 Në Prokurorinë e Përgjithshme është regjistruar praktika nr. 805/2015 mbi bazën e ankesës së shtetasit L.H., banues në Burrel, letërankesë e panëshkruar. Nga të dhënat e ankesës pretendohet se prokurori Abaz Muça e ka dërguar ankuesin në gjyq për veprën penale “fyerje për shkak të detyrës”, parashikuar nga neni 239/1 i Kodit Penal, veprë e cila ishte shfuqizuar, si dhe i bënte presion për para.

Pas verifikimeve të kryera, shtetasi L. H. ka shpjeguar se ishte me banim në fshatin *** dhe jo në qytetin e Burrelit dhe se nuk kishte dërguar asnjë ankesë ndaj prokurorit. Ai ka shpjeguar se çështja ishte pushuar në gjykim, pasi dispozita ishte shfuqizuar dhe se nuk kishte pasur asnjë problem me prokurorin e çështjes. Praktika e kësaj ankese anonime është arkivuar në datën 13.7.2015.

2.8 Në Prokurorinë e Përgjithshme është regjistruar praktika nr. *** mbi bazën e ankesës së shtetasit B.C., banues në Burrel, letërankesë e panëshkruar. Nga të dhënat e ankesës pretendohet se prokurori Abaz Muça, së bashku me gjyqtarin M. Ll., u bënë presion njerëzve, si dhe shfaq sjellje joetike.

Pas verifikimeve të kryera, shtetasi B.C. ka konfirmuar se nuk ka bërë asnjë ankesë dhe se nuk ka pasur asnjë mosmarrëveshje me prokurorin Abaz Muça. Praktika e kësaj ankese anonime është arkivuar në datën 13.7.2015.

2.9 Në Prokurorinë e Përgjithshme është regjistruar praktika nr***mbi bazën e ankesës së shtetasit S. Gj., banues në ***, Burrel. Ankuesi pretendon se prokurori Abaz Muça e ka futur në burg pa pasur masë sigurimi nga gjykata, duke u gjykuar me gjykim të drejtpërdrejtë. Më pas ka nxjerrë urdhërekzekutimin dhe duke mos pasur masë sigurimi ka kërkuar shuarje mase ndaj ankuesit.

Drejtori i Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme, me shkresën nr***, datë 13.7.2015, pasi ka administruar aktet e nevojshme, ka kthyer përgjigje duke sqaruar ankuesin në lidhje me pretendimet e tij. Drejtorja e Inspektimit ka konstatuar se veprimet e kryera nga Prokuroria Mat dhe qëndrimi i drejtuesit të kësaj prokurorie rezultojnë të bazuara në ligj, duke mos ndeshur veprime që vijnë në kundërshtim me përmbushjen e detyrës. Praktika është arkivuar në datën 22.7.2015.

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Abaz Muça, për vitet kalendarike 2014, 2015 dhe 2016 ka të arkivuara në Sektorin e Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme vlerësimet e punës “shumë mirë”, të kryera nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 42, të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Urdhrin nr. 221, datë 19.11.2012, “Për miratimin e rregullores për sistemin e vlerësimit të punës dhe aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve”.

Analiza e gjetjeve²³

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurorit Abaz Muça, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se: për vitet 2014, 2015 dhe 2016, prokurori Abaz Muça është vlerësuar “shumë mirë”, mbështetur në treguesit vjetorë të punës. Ka shfaqur aftësi dhe diskrecion në menaxhimin e drejtë dhe në kohë reale të shumëllojshmërisë dhe kompleksitetit të çështjeve që e karakterizojnë Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat. Ka marrë pjesë në mënyrë aktive në trajnimet e ndryshme në kuadër të rritjes së nivelit profesional, përditësimit me ndryshimet dhe praktikatat e reja ligjore të zbatuara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret.

Për sa i përket vlerësimit në aspektin profesional, rezulton se ka shfaqur aftësi në interpretimin e ligjit, analizën e jurisprudencës dhe arsyetimit ligjor e logjik, duke marrë vendime dhe përpiluar akte të qarta e të plota. Gjithashtu, ka marrë pjesë në aktivitete profesionale për ngritjen e nivelit të tij profesional.

b) Arsyetimi ligjor

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurori Abaz Muça, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se:

- Për vitet 2014, 2015 dhe 2016 prokurori Abaz Muça është vlerësuar “shumë mirë”, mbështetur në treguesit vjetorë të punës. Ka shfaqur aftësi dhe diskrecion në menaxhimin e

²³Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73-76 të ligjit nr. 96/2016.

drejtë e në kohë reale të shumëllojshmërisë dhe kompleksitetit të çështjeve që e karakterizojnë Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat.

Bazuar në aktet e dorëzuara dhe në dosjet e shortuara konstatohet se subjekti i rivlerësimit Abaz Muça shfaq aftësi në pasqyrimin e rrethanave të faktit, në analizën e provave dhe ballafaqimin e tyre me bazën ligjore të aplikueshme. Aktet e përpiluara prej tij paraqiten të qarta dhe të kuptueshme. Respektohen përgjithësisht rregullat e drejtshkrimit dhe niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara është në përputhje me standardin e procesit të rregullt ligjor.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti Abaz Muça ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës, ku i ka kryer hetimet, si dhe drejtuar e kontrolluar veprimtarinë hetimore brenda një afati të arsyeshëm në raport me kompleksitetin dhe shumëllojshmërinë e çështjeve, ndërkohë që këto fakte janë prezantuar edhe në vlerësimin e saj përgjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm, ku vlerësimi për këto vite ka qenë “shumë mirë”.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka trajtuar 301 procedime penale gjatë tre viteve të fundit të ushtrimit të detyrës, duke mos mbartur asnjë çështje. Duke iu referuar vërtetimit nr. 179/1, datë 30.1.2019, dhe listës së statistikave, vënë në dispozicion të Komisionit në procedurën e shortimit të dosjeve të datës 5.2.2019, konstatohet se janë 255 çështje të trajtuara nga subjekti i rivlerësimit të marra në shqyrtim për shortim.

Duke pasur parasysh statistikën e ngarkesës së punës, si dhe natyrën e çështjeve, konstatohet se prokurori Abaz Muça është përballur me një ngarkesë të konsiderueshme pune duke treguar eficiencë në marrjen e vendimeve brenda një afati të arsyeshëm, referuar natyrës dhe shumëllojshmërisë së veprimeve hetimore.

Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura në shortin e zhvilluar në datën 5.2.2019, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, për përzgjedhjen e pesë dokumenteve ligjore për periudhën e vlerësimit, tetor 2013 – tetor 2016, rezulton se afatet kohore të zgjidhjes së praktikave që kanë lidhje me dokumentet ligjore të përzgjedhura me short, janë të arsyeshme²⁴ në raport me natyrën dhe kompleksitetin e praktikave përkatëse.

Në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti Abaz Muça ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës, duke kryer detyrat e ngarkuara me efikasitet.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore

Nga vlerësimet e punës së prokurorit Abaz Muça për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se:

- Për vitet 2014, 2015 dhe 2016 prokurori Abaz Muça është vlerësuar “shumë mirë”, mbështetur në treguesit vjetorë të punës. Ka shfaqur aftësi dhe diskrecion në menaxhimin e drejtë e në kohë reale të shumëllojshmërisë dhe kompleksitetit të çështjeve që e karakterizojnë Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat.

Subjekti i rivlerësimit, në rastin e vendimmarrjes mbi mosfillimin e procedimit penal, rezulton të ketë argumentuar mungesën e elementëve të veprës penale. Në procedimet penale, për të cilat është vendosur pushimi i hetimeve, është realizuar drejtimi i hetimeve të kryera nga policia

²⁴Konkretisht kohëzgjatja e trajtimit të praktikave që lidhet me dosjet 1, 2, 3, 4 dhe 5 ka qenë: dosja nr. 1 - kohëzgjatja 30.12.2013 - 17.1.2014 (18 ditë); dosja nr. 2 - kohëzgjatja 6.6.2014 - 10.9.2014 (3 muaj e 3 ditë); dosja nr. 3 - kohëzgjatja 28.6.2016 - 21.7.2016 (23 ditë); dosja nr. 4 - kohëzgjatja 28.5.2015 - 15.7.2015 (1 muaj e 18 ditë); dosja nr. 5 - kohëzgjatja 4.9.2015 - 16.10.2015 (1 muaj e 12 ditë).

gjqësore duke argumentuar vendimmarrjen për pushimin e procedimeve penale. Subjekti i rivlerësimit ka shfaqur aftësitë e nevojshme edhe mbi kontrollin e hetimeve të kryera nga policia gjyqësore për të mbështetur akuzën në çështjet me të pandehur të dërguar për gjykim.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vlerësimet e punës së prokurorit Abaz Muça për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se:

- Për vitet 2014 – 2015 – 2016, prokurori Abaz Muça është vlerësuar “shumë mirë”, mbështetur në treguesit vjetorë të punës. Ka shfaqur aftësi dhe diskrecion në menaxhimin e drejtë e në kohë reale të shumëllojshmërisë dhe kompleksitetit të çështjeve që e karakterizojnë Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat.

Nga vëzhgimi i akteve të dorëzuara nga subjekti dhe pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurori Abaz Muça, në ushtrim të kompetencave të tij, ka aftësi për të administruar dosjet.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga vlerësimet e punës së prokurorit Abaz Muça për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se:

- Për vitet 2014, 2015 dhe 2016 prokurori Abaz Muça është vlerësuar “shumë mirë”, mbështetur në treguesit për etikën profesionale të prokurorit. Disiplina në punë, bashkë me etikën në veshje dhe sjellje të prokurorëve dhe gjithë stafit ka qenë në fokusin kryesor dhe konstant gjatë punës së tij si drejtues prokurorie, duke u bërë vetë shembull në respektimin e këtyre normave, si dhe duke insistuar në ndjekjen e shembullit të tij nga të gjithë vartësit, cilësi kjo e cila e ka ndryshuar ndjeshëm perceptimin e publikut në raport me punën dhe rolin e prokurorit në këtë prokurori.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurori Abaz Muça, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Abaz Muça. Në asnjë prej dokumenteve dhe dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Gjithashtu, në asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Nga vlerësimet e punës së prokurorit Abaz Muça për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se:

- Për vitet 2014 – 2015 – 2016 prokurori Abaz Muça është vlerësuar “shumë mirë”, mbështetur në treguesit vjetorë të punës. Ka pasur një komunikim dhe ndërveprim korrekt me kolegët, eprorët dhe vartësit, duke vlerësuar dhe respektuar rolin dhe pozicionin e secilit prej tyre. Gjatë punës si drejtues prokurorie ka shfaqur aftësi të veçantë për sa i përket

ndërtimit dhe ruajtjes së marrëdhënieve korrekte me të gjitha institucionet ligjzbatuese me të cilat ka ndërvepruar.

Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk rezultojnë të dhëna që flasin për mënyrën e komunikimit ndërpersonal të subjektit me pjesëmarrësit në proces.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Nga vlerësimet e punës së subjektit Abaz Muça për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se:

- Për vitet 2014, 2015 dhe 2016 subjekti Abaz Muça është vlerësuar “shumë mirë”, mbështetur në treguesit vjetorë të punës. Ka treguar aftësi të lartë drejtuese e kontrolluese duke bërë një organizim shumë të mirë të punës në prokurori, duke rregulluar organizimin dhe mirëfunksionimin e punës së çdo strukture nëpërmjet urdhrave të detajuar, duke mbajtur nën kontroll të vazhdueshëm ecurinë efektive të hetimeve dhe punën e secilit prokuror. Ka shfaqur aftësi të veçanta dhe këmbëngulje në organizimin me efektivitet të burimeve materiale dhe njerëzore të prokurorisë që drejton duke i menaxhuar me përsosmëri këto burime. Ka bashkëpunuar frytshëm me të gjitha institucionet shtetërore duke mbajtur një komunikim korrekt në përputhje me normat ligjore dhe morale me publikun dhe me personat e tretë.

Bazuar në të gjitha burimet e informacioneve të këtij raporti nuk rezultojnë të dhëna konkrete që flasin mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar mes kolegësh apo më gjerë.

c) Gatishmëria për t’u angazhuar

Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t’u angazhuar për periudhën objekt vlerësimi, subjekti Abaz Muça rezulton të jetë angazhuar në një sërë aktivitete profesionale të organizuara.

Gjithashtu, në periudhën e rivlerësimit, subjekti deklaron se ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh brenda dhe jashtë Shkollës së Magjistraturës, duke shprehur gatishmërinë e tij për t’u rritur nga ana profesionale.

C/1. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Komisioni, pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer nga KLP-ja dhe dosjeve ku është bazuar ky raport, nuk ka konstatuar problematika në lidhje me tri dokumentet ligjore të depozituara prej tij, por as edhe lidhur me pesë dosjet e shortuara. Ndërsa sa i përket konstatimeve në ankesat e depozituara të pasqyruara në seksionin e të dhënave arkivore, pas trajtimit të tyre, Komisioni konstatoi se subjekti, për ankesat referuar në pikat 2.2 dhe 2.3, ka dhënë shpjegime bindëse²⁵, ka qartësuar statusin e tyre, si dhe nuk evidenton ndonjë problematikë që lidhet me vlerësimin e kriterit profesional.

Në lidhje me 11 (disa të përsëritura) denoncimet²⁶ e paraqitura për subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, Komisionit i ka rezultuar, si vijon:

1. Denoncim²⁷ i shtetasit I. Xh.

Denoncuesi ankohet se subjekti i rivlerësimit ka mbyllur hetimin për disa shtetas në kundërshtim me ligjin, duke pretenduar se prej tyre janë marrë nga nëpunësi i gjendjes civile certifikata false për të votuar në zgjedhjet e pleqësisë. Denoncuesi ka depozituar, ndër të tjera, edhe një ankim ndaj vendimit gjyqësor nr***, datë 17.10.2012.

Trupi gjykues, për këtë denoncim, ka konstatuar se nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nuk identifikohet subjekti i rivlerësimit. Në kushte të tilla nuk duket se vërehen

²⁵Referojuni shpjegimeve të subjektit.

²⁶Ku dy prej denoncuesve kanë paraqitur dy herë të njëjtin denoncim, pra, me të njëjtin objekt kërkimi.

²⁷Nr. *** prot, datë 7.12.2017.

problematika apo diktohen *indicie* në lidhje me subjektin e rivlerësimit, në raport me përmbushjen e komponentëve të kërkuar për vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

2. Denoncim²⁸ i shtetasit Xh. Xh.

Denoncuesi ankohet se subjekti i rivlerësimit nuk i ka dhënë të drejtën e rehabilitimit bashkëshortes së tij, lidhur me vjedhjen e shpërblimeve të pagave të punonjësve duke u përdorur dokumente false. Denoncuesi ka depozituar disa akte, ku ndër të tjerë, identifikohet edhe një kallëzim i vitit 2007, i bërë nga bashkëshortja e tij, për të cilin Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, me një tjetër subjekt rivlerësimi, ka vendosur më 7.7.2008 pushimin e procedimit penal nr. ***, që bën fjalë për veprën penale të parashikuar nga nenet 135 dhe 186 të Kodit Penal.

2.1 Trupi gjykues, për këtë denoncim nga aktet e depozituara bashkëngjitur denoncimit, nuk ka konstatuar *indicie* ndaj subjektit të rivlerësimit në raport me vlerësimin e tij profesional, pasi në asnjë prej tyre nuk identifikohet roli dhe ushtrimi i detyrës prej tij.

3. Denoncim²⁹ i shtetasit S. L.

Paraprakisht duhet thënë se përmbajtja e denoncimit duket e pakuptueshme dhe, për pasojë, nuk arrihet të kuptohet edhe objekti i kërkimit të denoncuesit. Gjithsesi, denoncuesi ka depozituar disa dokumente, nga verifikimi i të cilave rezulton se në vitin 2012 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, me një tjetër subjekt rivlerësimi ka pushuar procedimin penal nr. ***, për veprën penale “kanosje”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal. Në vendim relatohet se ka pasur një konflikt pronësie dhe se për këtë shkak janë kallëzuar dy shtetas për të cilët është pretenduar se kanë kanosur djalin e denoncuesit.

3.1 Trupi gjykues, për këtë denoncim në tërësi të pretendimeve dhe aktit të sqaruar më sipër, ka konstatuar se nuk jepen *indicie* lidhur me rolin e subjektit të rivlerësimit në këtë çështje.

4. Denoncim³⁰ i shtetasit H.R.

Denoncuesi ankohet ndaj subjektit të rivlerësimit nën pretendimin se prej këtij të fundit janë pushuar disa herë çështje. Denoncuesi ka depozituar dokumente të ndryshme, në tërësinë e të cilave nuk vërehen akte të pushimit të çështjeve penale (sikurse pretendohet), ndërsa identifikohet një kërkesë e organit të akuzës, konkretisht, e subjektit të rivlerësimit drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat për dërgimin e çështjes në gjyq, që i përket procedimit penal nr. ***, me të pandehur denoncuesin, akuzuar për veprën penale “shkatërrim të pronës”, “kanosje për shkak të detyrës” dhe “prishje të qetësisë publike”, parashikuar nga nenet 150, 238 dhe 274 të Kodit Penal, në dëm të ZVRPP-së Mat.

Trupi gjykues për këtë çështje i ka kërkuar subjektit të qartësonte statusin aktual të kësaj çështjeje, për të cilën ka dhënë shpjegime të detajuara të lidhura me: (i) rrethanat e çështjes; (ii) analizën e provave të marra gjatë hetimit të çështjes penale dhe shqyrtimit gjyqësor të saj, si dhe arsyetimit të qëndrimit të mbajtur nga ana e tij; (iii) parashtrimin se ndaj vendimit nr. ***, datë 6.12.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat është ushtruar ankim nga ana e të pandehurit H. R. në Gjykatën e Apelit Tiranë, i cili është ende në proces gjykimi në këtë gjykatë, sipas shënimit të shënuar nga kancelarja Sh. C. në vendimin nr. ***, datë 6.12.2019; (iv) depozitim të dokumentacionit³¹ mbështetës mbi shpjegimet e dhëna.

²⁸Nr***prot, datë 7.12.2017.

²⁹Nr***prot., datë 2.10.2018.

³⁰Nr. *** prot., datë 6.12.2018.

³¹Kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq datë 3.12.2018, 8 fletë; vendimi nr. ***, datë 15.1.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat për dërgimin e çështjes në gjyq, 4 fletë; konkluzionet përfundimtare për procedimin penal nr***, të vitit 2018, në ngarkim të të pandehurit H. R., 8 fletë; vendimi nr. ***, datë 6.12.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, së bashku me shënimin përkatës, 11 fletë.

5. Denoncim i shtetasit A.Ç.

5.1 Denoncuesi ankohet se subjekti i rivlerësimit në kundërshtim me ligjin ka vendosur mosfillimin e procedimit penal lidhur me materialin e tij kallëzues nr. ***, datë 22.10.2018. Denoncuesi, ndër të tjera, sqaron se ka depozituar kallëzim për shkatërrim të pronës së tij, pasi pikërisht në këtë të fundit është bërë një ndërtim i paligjshëm, më konkretisht është ndërtuar një shtyllë e tensionit të lartë, prej shoqërisë “****” sh.p.k. Denoncuesi pretendon se nga prokurori i çështjes/subjekti i rivlerësimit është arritur në këtë vendimmarrje pa një arsytim ligjor, duke theksuar se nga OPGJ-ja, në rastin konkret, është konkluduar se në pronën e denoncuesit është kryer një ndërtim pa leje. Denoncuesi, gjithashtu, ka sqaruar se ky vendim është prishur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat dhe se subjekti i rivlerësimit e ka apeluar atë. Në vijim, denoncuesi nuk ka dhënë detaje të tjera mbi këtë çështje.

5.2 Subjekti i rivlerësimit³² ka informuar se çështja është ende në proces gjykimi në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe për të provuar këtë fakt, ka depozituar vërtetimin nr. ***prot., datë 28.5.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, si dhe fashikullin penal.

Nga analizimi i fashikullit rezultoi si vijon:

Mbi rrethanat e çështjes

5.3 Shtetasi A. Ç., me cilësinë e ankuesit, ka bërë kallëzim në Komisaratin e Policisë Mat më 17.10.2018 dhe, më pas, edhe një shtesë në kallëzim në datën 29.10.2018, ku ka kallëzuar një ndërtim të paligjshëm nga shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k., me administrator shtetasin M.P., të një shtylle të tensionit të lartë në truallin e tij pronë e trashëguar, të cilën e ka fituar ligjërisht me vendim të KKKPronave dhe me vendim gjyqësor, për të cilin është pajisur me certifikatën e pasurisë dhe kartelën përkatëse. Denoncuesi pretendon se për këtë ndërtim nuk është marrë leje ndërtimi nga organet kompetente dhe ka kërkuar të kryhen këto verifikime, duke shtuar që të verifikohet nëse ka projekt zbatimi për këtë ndërtim dhe nëse është miratuar. Kallëzuesi ka sqaruar se fillimisht ka komunikuar me përfaqësues të shoqërisë ndërtuese për t'i kërkuar kompensimin financiar me çmimin që do të vendoste për metër katror ose në të kundërt t'i lirohej pronësia. Në vijim, ka deklaruar se nga shoqëria ndërtuese i është kërkuar dokumentacioni provues i pronësisë. Më tej, denoncuesi ka deklaruar se prej këtij momenti nuk ka arritur të komunikojë me përfaqësues të shoqërisë ndërtuese, e cila ka pretenduar se ka komunikuar me kallëzuesin dhe se i ka bërë me dije se kishte leje ndërtimi të miratuar nga Ministria e Energjetikës dhe se shtetasi A.Ç. do të shpronësohej për zënie të tokës për interes publik.

5.4 Subjekti, në vendimin e mosfillimit, datë 2.11.2018, e ka trajtuar çështjen kryesisht të një konflikti gjyqësor administrativo-civil, duke çmuar se rasti mund të zgjidhej në rrugë gjyqësore me padi civile. OPGJ-ja, në relacionin e tij, ka sugjeruar mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin e regjistruar me nr. ***, viti 2018.

5.5 Konkludimet e vendimit gjyqësor (detyrat e lëna në prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për hetime të mëtejshme) nr. ***, datë 12.2.2019, ku është vendosur shfuqizimi i vendimit të mosfillimit që i përket kallëzimit penal të pasqyruar më sipër, janë si vijon:

5.5.i Nga prokuroria nuk janë kryer të gjitha veprimet verifikuese dhe hetimore, administrimi i akteve dhe provave, të cilat japin një pasqyrim të saktë të fakteve që tregojnë se fakti penal për të cilin pretendohet nga kallëzuesi nuk ekziston. Prokurori, pjesërisht, ka kryer hetime të mirëfillta, por që nuk ka bërë regjistrimin e procedimit penal dhe vazhdimin apo thellimin e këtyre hetimeve të domosdoshme për zgjidhjen e plotë dhe të drejtë të çështjes.

5.5.ii Vendimi i organit të prokurorisë nuk ka parashtruar të gjitha rrethanat e faktit dhe arsytet ligjore, të cilat qëndrojnë në mbështetje të konkluzionit të arritur prej saj, si dhe nuk ka

³²Me shkresën nr. ***prot., datë 31.5.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

analizuar dhe arsyetuar drejt moskzistencën e elementëve të anës objektive dhe subjektive për të dyja veprat penale “ndërtim i paligjshëm” dhe “shkatërrim të pronës”, të kallëzuar nga shtetasi A.Ç. .

5.5.iii Në të tilla kushte, gjykata ka çmuar se duhet të regjistrohet kallëzimi dhe se duhet hetuar për të dyja veprat penale.

5.6 Më konkretisht, detyrat e lëna për të provuar mbi veprën penale “shkatërrim të pronës”, referojnë: (i) faktimin nëse ndërtimi kryhet në pronën e kallëzuesit; (ii) kryerjen e aktekspertimit topografik; (iii) kryerjen e aktekspertimit vlerësues nëse ndërtimet e prishin regjimin e tokës; (iv) me këtë akt të vlerësohet sa është vlera e dëmit të shkaktuar për të konkluduar nëse dëmtimet janë të lehta apo të rënda, për të vlerësuar nëse është përpara një fakti penal apo civil të dëmit të shkaktuar, si dhe të kryhen hetime të tjera të diktuar apo që dalin nga dinamika e hetimit apo faktet e pretenduara nga palët.

5.7 Ndërsa detyrat e lëna për të provuar mbi veprën penale “ndërtim i paligjshëm” referojnë disa veprime hetimore që duhet të kryhen nga organi i akuzës. Më konkretisht, të hetohet: (i) nëse subjekti që po kryen punimet ka leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtimin në fjalë; (ii) kush e ka lëshuar lejen dhe a është zbatuar ajo; (iii) nëse ka leje a po kryhen punimet brenda afatit dhe kushteve të parashikuara në lejen zhvillimore dhe ndërtimore; (iv) administrimi i dokumenteve teknike mbi të cilat po kryhet ndërtimi i linjës së tensionit të lartë 110 kw, si dhe të kryhen hetime të tjera të diktuar apo që dalin nga dinamika e hetimit apo faktet e pretenduara nga palët.

5.8 Komisioni, pas analizimit të akteve të administruara në dosje sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kërkuar subjektit të shpjegojë lidhur me mosndërmarrjen e veprimit hetimor të caktuar prej tij në urdhrin datë 23.10.2018, “Për kryerjen e veprimeve verifikuese”, për të pasur informacion nëse kjo pronë është bërë objekt gjykimi në gjykatë me qëllim, më tej, administrimin e vendimit/eve gjyqësor/e; si dhe të paraqesë argumentet e tij në raport me detyrat e lëna për kryerjen e hetimeve të mëtejshme, sikundër është cilësuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat në vendimin e shfuqizimit të vendimit për mosfillimin e procedimit penal nr. ***.

5.9 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e tij, ka parashtruar rrethanat e faktit të çështjes dhe arsyetimin ligjor, sipas të cilit ka mbështetur vendimmarrjen e tij. Lidhur me konstatimet e Komisionit, subjekti ka parashtruar se për shkak të funksionit të ushtruar më parë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat kishte pasur dijeni lidhur me çështjet që kishin të bënin me kallëzuesin A. Ç. të tilla si: procedimi penal nr. ***, viti 2012, me kallëzues shtetasin H.D. dhe të kallëzuar shtetasin A. Ç.; procedimi penal nr. ***, viti 2014, me kallëzues shtetasin H.D.; procedimi penal nr. ***, viti 2017, me kallëzues shtetasin A.Ç.; procedimin penal nr. ***, viti 2020, regjistruar mbi bazën e kallëzimit të bërë nga shoqëria koncesionare “****” sh.p.k., duke pasqyruar edhe statusin ligjor të tyre sipas mjeteve ligjore të ndërmarrja nga palët, si dhe disponimet e gjykatave.

5.10 Lidhur me detyrat e lëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat për kallëzimin nr. ***, të vitit 2018, nga shtetasi A. Ç., subjekti ka parashtruar se nga ana e tij është administruar dokumentacioni ligjor për kryerjen e punimeve në rrugë dhe në linjën elektrike 110 kw për hidrocentralin e ***, në Bashkinë K. të rrethit Mat. Ndërtimi i hidrocentralit, ***1, ***2, *** 3 dhe *** 4, në Bashkinë K., ka qenë me kontratë koncesionare të miratuar me vendim qeverie, me projekt të miratuar nga Ministria e Energjetikës. Administratori i shoqërisë “****” sh.p.k., M. P., në zbatim të projektit të ndërtimit të hidrocentralit ***1, ***2, ***3 dhe *** 4, në Bashkinë K., kishte kryer punimet elektrike të linjës 110 kw, të miratuara nga OST-ja (Operatori i Sistemit të Transmetimit), ku ky operator kishte miratuar pikën e lidhjes me sistemin elektroenergjetik shqiptar. Kjo linjë elektrike ishte e lidhur në tensionin 110 kw K.-B.-P. . Nga veprimet verifikuese ka rezultuar se administratori i shoqërisë “****” sh.p.k., M. P.,

si dhe shoqëria koncensionare “****” sh.p.k., për punimet në rrugë dhe në linjën elektrike 110 kw, si dhe për ndërtimin e hidrocentralit ***1, *** 2, ***3 dhe ****4, në Bashkinë K., kishte dokumentacionin ligjor, si vijon:

- kontratë dhe amendim kontrate koncensionare e shoqërisë “****” sh.p.k., regjistruar në QKB me NIPT ***, më 2.3.2009 (ndërtim-operim-transferim), për ndërtimin e hidrocentralit të ***, K.;
- raportin e oponencës teknike për projektin e zbatimit të ripunuar të hec-eve***1 dhe ***2 të shoqërisë koncensionare “****” sh.p.k., datë 16.8.2018;
- miratimin e projekt-zbatimit të ripunuar për hec-et ***1 dhe *** 2 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë datë 28.8.2018;
- aktin e miratimit të projektit elektrik, datë 31.8.2018, nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial;
- projektin elektrik të linjës 110 kw, që lidh hec-et *** 1 dhe ***2 me rrjetin energjetik shqiptar, datë 11.5.2018;
- komente nga OST-ja mbi projekt-zbatimin e ndërtimit të linjës 110 kw me dy qarqe të hec-ve ***, në çarje të linjës 110 kw K.-Bulqizë;
- marrëveshjen nr. *** prot., datë 20.6.2018, ndërmjet OST-së dhe “****” sh.p.k.;
- lejen e ndërtimit nr. ***, datë 25.10.2010, nga Bashkia K., si dhe miratimin e shtesës së lejes nr. ***dhe nr. ***, datë 25.10.2010, mbështetur në ndryshimet për zgjatjen e afatit kohor të ndërtimit të hec-eve ***, që ka bërë autoriteti kontraktor (METE) në vijim të kontratave shtesë;
- kontratën e nënsipërmarrjes që lidhet nga shoqëria “****” sh.p.k., me shoqërinë “****”, datë 8.6.2018, me objekt “sheshet dhe bazamentet e shtyllave të tensionit 110 kw, për lidhjen e nënstacionit të *** me linjën 110 kw K.-B.-D.;
- kontratën shtesë të koncesionit, datë 23.1.2013, për një ndryshim në kontratën e koncesionit, të ndryshuar, të formës “****” për ndërtimin e hec-eve “****1”, “**** 2”, “**** 3” dhe “****4”, bazuar në VKM-në nr. 448, datë 16.6.2010, me palë Autoritetin Kontraktues (Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës) dhe shoqërinë koncensionare (“****” sh.p.k.);
- kontratën shtesë të koncesionit, datë 6.8.2013, për një ndryshim në kontratën e koncesionit, të ndryshuar, të formës “****” për ndërtimin e hec-eve “****1”, “**** 2”, “****3”, me palë autoritetin kontraktues (Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës) dhe shoqërinë koncensionare (“****” sh.p.k.);
- kontratën shtesë të koncesionit, datë 6.8.2015, për një ndryshim në kontratën e koncesionit, të ndryshuar, të formës “****” (ndërtim-operim-transferim) për ndërtimin e hec-eve “**** 1”, “**** 2” dhe “**** 3”, me palë autoritetin kontraktues (Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës) dhe shoqërinë koncensionare (“****” sh.p.k.);
- kontratën shtesë të koncesionit, datë 25.5.2017, për një ndryshim në kontratën e koncesionit, të ndryshuar, të formës “****” (ndërtim-operim-transferim) për ndërtimin e hec-eve “****1”, “**** 2” dhe “**** 3”, me palë autoritetin kontraktues (Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës) dhe shoqërinë koncensionare (“****” sh.p.k.);
- amendim kontrate, datë 28.9.2018, për një ndryshim në kontratën e koncesionit, të ndryshuar, të formës “****” (ndërtim-operim-transferim) për ndërtimin e HEC-eve “****1”, “**** 2”, “****3”, me palë autoritetin kontraktues (Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës) dhe shoqërinë koncensionare (“****” sh.p.k.);
- formularin e sigurimit të kontratës, datë 11.9.2018;
- preventivin përmbledhës - hidrocentrali *** 1;
- preventivin përmbledhës - hidrocentrali ***2;
- miratimin e kërkesës nr. *** prot., datë 16.9.2014, dhënë nga Bashkia K., drejtuar shoqërisë koncensionare “****” sh.p.k., subjektit ndërtues “****M” sh.p.k., me nr. licence ***, ku ka

konfirmuar miratimin e zgjatjes së afatit kohor të lejes së ndërtimit për hidrocentralet “***1, 2 dhe 3”, dhënë me vendimet nr. *** dhe nr. **, datë 25.10.2010, të KRT-së K. .

5.11 Sipas subjektit, gjithë dokumentacioni i referuar më sipër ka qenë i administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat dhe kjo e fundit ka anashkaluar dhe arsyetuar në përgjithësi në kundërshtim me faktet që ndodhen të administruara në dosjen objekt gjykimi. Subjekti ka parashtruar, në këto rrethana, se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka cenuar parimin e procesit të rregullt ligjor atë të paanësinë, duke mospërmbushur kërkesat e ligjit procedural penal për arsyetimin e vendimit dhe konkretisht nuk ka cituar provat e paraqitura prej tij në seancë gjyqësore në lidhje me vendimin e mosfillimit të procedimit penal. Subjekti shprehet se kjo gjykatë nuk ka bërë arsyetim ligjor në lidhje me çështjen, por vetëm është marrë me pretendimet e ankuesit A.Ç. dhe jo me aktet e administruara nga organi i prokurorisë.

Subjekti shprehet se: “... lidhur me marrjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal kam vepruar brenda afateve ligjore dhe në mbështetje të kërkesave të neneve 290 dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale, pasi në rastin objekt kallëzimi është vlerësuar se jemi para një mosmarrëveshjeje të pastër juridiko-civile, pasojat e të cilave zgjidhen nga gjykata, si dhe është në proces gjykimi në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila do të konkludojë në lidhje me materialin kallëzues nr***, të vitit 2018, me kallëzues shtetasin A.Ç. ”.

5.12 Për këtë rast, Këshilli i Ministrave, Këshilli Kombëtar i Territorit, me vendimin nr. **, datë 12.7.2019, “Për rishikimin e kushteve dhe shtyrjen e afatit të lejes ekzistuese për objektin: ‘ndërtimi i hidrocentraleve *** 1 dhe ***2’, në përroin e **, Bashkia K.”, ka vendosur: “Miratimin e rishikimit të kushteve dhe shtyrjen e afatit të lejes ekzistuese për objektin “ndërtimi i hidrocentraleve ***1 dhe *** 2’, në përroin e **, Bashkia K., me subjekt zhvillues shoqërinë ‘***’ sh.p.k. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi”.

5.13 Për të mbështetur shpjegimet e tij, subjekti ka depozituar dokumentacionin sa më poshtë referohet:

- vendimin nr. **, datë 12.7.2019, të Këshillit të Ministrave, Këshillit Kombëtar të Territorit, 4 fletë;
- urdhrin për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale datë 3.12.2012 – prokurori L. F., 3 fletë;
- kërkesa për gjykimin e çështjes nr. **, të vitit 2012 – prokurori L. F., 4 fletë;
- vendimin nr. **, datë 19.11.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat së bashku me shënimet përkatëse, 5 fletë;
- urdhrin për regjistrimin e procedimit penal nr. **, të vitit 2014 – prokurori L. F., 1 fletë;
- vendimin e parë datë 20.3.2015, për pushimin e çështjes nr***, të vitit 2014 – prokurori L. F., 3 fletë;
- vendimin për shfuqizimin e procedimit penal nr. **, të vitit 2014, 7 fletë;
- vendimin e dytë datë 29.7.2015, për pushimin e çështjes nr. **, të vitit 2014 – prokurori L. F., i ankimuar në gjykatë dhe i lënë në fuqi, 3 fletë;
- urdhrin për regjistrimin e procedimit penal nr. **, të vitit 2017 – ish-prokurorja A. N., 2 fletë;
- urdhrin për regjistrimin e procedimit penal nr. **, të vitit 2018 – ish-prokurori H. V., 2 fletë;
- kërkesat nr. **, të vitit 2017 dhe nr. **, të vitit 2018, për pushimin e çështjes – ish-prokurori H. V., 10 fletë;
- kërkesat nr. **, të vitit 2017 dhe nr. **, të vitit 2018, për dërgimin e çështjes në gjyq për të pandehurën B. K.– ish-prokurori H. V., 9 fletë;
- kërkesën për pushimin e çështjes nr. **, të vitit 2017 – ish-prokurori H. V., 6 fletë;

- vërtetimin nr. ***prot., datë 14.6.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, 1 fletë;
- shkresën nr. *** prot., datë 28.4.2020, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, 1 fletë;
- urdhrin për regjistrimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2020 – subjekti i rivlerësimit Abaz Muça, 2 fletë;
- kërkesën për pushimin e çështjes nr. ***, të vitit 2020 – subjekti i rivlerësimit Abaz Muça, 14 fletë;
- aktekspertimin tekniko-grafik nr. ***, datë 29.5.2020, i kryer nga Instituti i Policisë Shkencore, 25 fletë;
- vërtetimin nr. ***prot., datë 14.6.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, 1 fletë.

5.14 Trupi gjykues, pas analizimit të kësaj çështjeje në raport me shpjegimet dhe provat e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, arsyeton se:

Për këtë çështje penale, që në objekt pasqyron një konflikt pronësie për ndërtimin e një shtylle të tensionit të lartë në një tokë të pretenduar, jo vetëm nga një palë, vërehet se nga denoncuesi, pretendues të tjerë të tokës, si dhe shoqëria ndërtimore që ka kryer ndërtimin, janë depozituar disa kallëzime respektive. U konstatua se përveç disa çështjeve penale, palët, gjithashtu, kanë pretendime edhe mbi mënyrën e përfitimit të pronësisë mbi të cilën është kryer ndërtimi, çka tregon se kemi të bëjmë me një çështje të përzier me pretendime të ndërsjella mes tyre. Përkundër shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, i cili kryesisht e ka trajtuar objektin e hetimit si një konflikt civil për t’u zgjidhur në rrugë gjyqësore, gjykata me vendimin e saj ka konstatuar moskryerje të disa veprimeve hetimore prej tij duke e kthyer çështjen për hetime të mëtejshme dhe, për pasojë, e ka vendosur subjektin në një analizim më të thelluar të çështjes. Trupi gjykues, nga njëra anë mban në konsideratë ankimin e ushtruar nga subjekti ndaj vendimit të gjykatës, ku dhe vëren se vijon t’i qëndrojë bindjes së tij në vendimmarrjen e mosfillimit të çështjes, por nga ana tjetër pa paragjykuar atë që mund të ndodhë në vendimmarrjen gjyqësore të radhës, por edhe pa zëvendësuar logjikën e subjektit në arsyetim, në analizë të vendimit të mosfillimit, konstaton se është hedhur dritë kryesisht mbi çështjen që i përket ndërtimit të paligjshëm në raport me çështjen tjetër që i përket shkatërrimit të pronës. Pra, nëse u vërejt se prej tij janë kryer disa verifikime dhe janë administruar prova, për sa i takon dhënies së lejes ndërtimore, afatit dhe zbatimit të saj, shpjegime të cilat u ezauruan edhe në seancë dëgjimore, vijueshmëria e verifikimit të kallëzimit mbi shkatërrimin e pronës duket se nuk ka marrë rëndësinë e duhur.

Trupi gjykues vlerëson se arsyetimi i vendimit do të duhej të pasqyronte më shumë të dhëna mbi këtë çështje në përputhje me veprimet që mund të kishte kryer.

Lidhur me pretendimet e denoncuesit që shoqëria ndërtimore duhet ta dëmshpërblente, për shkak të ndërtimit në pronën e pretenduar prej tij, duket se kemi të bëjmë me një ndërtim të kryer për interes publik dhe kërkimet e palëve për shpronësim apo dëmshpërblim dukshëm do të referonin konflikte civile, megjithatë edhe në këtë rast gjykata ka vlerësuar kryerjen e disa veprimeve hetimore.

Në këto kushte: (i) për sa kohë shpjegimet e subjektit, dhënë rast pas rasti për këtë çështje, nuk janë ezauruan plotësisht në trajtimin e saj apo edhe në vendimmarrjen e mosfillimit, siç edhe është konkretizuar deri aktualisht në vendimmarrjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat; (ii) pavarësisht faktit se çështja është ankimuar nga subjekti, por ende nuk është gjykuar; trupi gjykues, në tërësi të kësaj çështjeje, konstaton se:

- i) pavarësisht se nga njëra anë faktet tregojnë se të dyja veprat, që lidhen me pretendime pronësore të palëve për një objekt në interes publik, ndërthuren me njëra-tjetrën dhe se hetimet e kryera, sigurisht, ndikojnë po ashtu njëra-tjetrën;

- ii) nga ana tjetër konstaton se lidhur me kallëzimin për shkatërrim prone, mund të ishin kryer veprime të tjera hetimore apo të ishte arsyetuar më gjerësisht për këtë çështje.

Për sa më sipër arsyetuar, trupi gjykues çmon se vlerësimi i këtyre mangësive, mbetur i vetëm dhe i papërsëritur, në kuadër të vlerësimit profesional, por edhe të procesit në tërësi, nuk është i mjaftueshëm që të ngrihet në nivelin e ndonjë kualifikimi ligjor për penalizimin e tij.

6. Denoncim³³ i shtetasit H. R.

Denoncuesi ka kërkuar të merren dosje gjyqësore dhe hetimore, si dhe ka depozituar disa akte administrative (kryesisht kthim-përgjigjeje) të institucioneve të ndryshme lidhur me konfliktin e tij pronësor, konkretisht për një truall së bashku me një studio piktori ndërtuar mbi të, për të cilin ka pretenduar se nuk i është regjistruar. Nga verifikimi i akteve bashkëngjitur, por edhe nga një relacion i OPGJ-së i vitit 2004 dhe vendimi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat (edhe këto dokumente janë depozituar nga denoncuesi) në vitin 2005 për dërgimin e çështjes në gjyq, nuk rezulton të jetë i përfshirë subjekti i rivlerësimit.

6.1 Trupi gjykues, lidhur me këtë denoncim në tërësi të pretendimeve të denoncuesit, pavarësisht shpjegimeve të dhëna nga subjekti, ka konstatuar se nuk jepen *indicie* që lidhen me subjektin në drejtim të vlerësimit profesional.

7. Denoncim³⁴ i shtetasit H. R.

Denoncuesi ka depozituar dy denoncime nën pretendimin se subjekti i rivlerësimit është i lidhur me kryetarin e gjykatës dhe kryetarin e bashkisë që është i inkriminuar.

Denoncuesi ka depozituar vendimin e pushimit të procedimit penal nr. ***, të vitit 2003, për të cilin trupi gjykues ka konstatuar se ky vendim jo vetëm rezulton se është marrë nga një tjetër subjekt rivlerësimi, por në këtë kohë subjekti i rivlerësimit nuk mbante detyrën e prokurorit, pasi është bërë subjekt në vitin 2008.

8. Denoncim³⁵ i shtetases Gj. T.

Paraprakisht, nga aktet e depozituara, nuk vërehet një denoncim në formën e kërkuar nga ligji nr. 84/2016, për të kuptuar objektin e kërimit, pra, nuk kemi një akt minimalisht të nënshkruar nga kjo shtetase, drejtuar Komisionit. Megjithatë, nisur nga dokumentacioni i depozituar, ndër të tjera, vërehen disa akte pronësore, kërtime të ndryshme ndaj disa institucioneve publike dhe kthim-përgjigjeje në adresë të kësaj shtetaseje. Po nga aktet e depozituara vërehet një vendim mosfillimi i organit të akuzës për procedimin penal nr. ***, marrë nga një tjetër subjekt rivlerësimi. Konstatohet se shkresa e njoftimit të këtij vendimi është nënshkruar nga drejtuesi i organit të akuzës, pra, nga subjekti i rivlerësimit.

8.1 Trupi gjykues, për këtë denoncim në tërësi të pretendimeve të denoncuesit, ka konstatuar se nuk diktohen problematika në adresë të subjektit të rivlerësimit.

9. Denoncim³⁶ i shtetasit H. R.

Denoncuesi, në përmbajtje të denoncimit, ankohet kryesisht ndaj gjyqtarit A.Ç., të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, nën argumentin se ky gjyqtar duke bashkëpunuar me prokurorinë dhe hipotekën kanë bërë të mundur marrjen e pronës së tij.

9.1 Trupi gjykues, në tërësi të parashtrimeve në denoncim, ka konstatuar pretendime që nuk përbëjnë lidhje apo identifikim të rolit dhe funksionit të detyrës së ushtruar nga subjekti i rivlerësimit. Konstatohet se denoncuesi në këtë denoncim nuk ka paraqitur asnjë dokument

³³Nr. ***, datë 8.1.2020.

³⁴Nr. ***prot., datë 28.1.2020 dhe nr. *** prot., datë 10.2.2020.

³⁵Nr. *** prot., datë 17.8.2020.

³⁶Nr. *** prot., datë 26.12.2019.

shoqërues, duke mos evidentuar ndonjë problematikë që mund të lidhej me kriterin profesional të subjektit.

10. Denoncim³⁷ i shtetases N. C.

Kjo shtetase ankohet ndaj kërkesës së depozituar përpara gjykatës nga organi i prokurorisë për pushimin e procedimit penal nr. ***³⁸, vënë në lëvizje nga denoncuesja, e cila ka dhënë disa detaje mbi çështjen për të cilën ka bërë kallëzimin përkatës (nën akuzën “falsifikim dokumentesh”), që kryesisht ka të bëjë me birësimin prej saj dhe të të ndjerit/bashkëshortit, të mbesës së këtij të fundit prej vitit 1991, për të cilin pretendon se janë falsifikuar dokumentet mbi vendimmarrjen e birësimit dhe se për këtë birësim ajo dhe i ndjeri/bashkëshorti nuk kanë pasur asnjëherë dijeni. Denoncuesja sqaron se vajza e birësuar bën përpjekje për të përfutur në një pronë të trashëguar nga i ndjeri/bashkëshorti i saj. Denoncuesja ka qartësuar se është pranuar kërkesa e organit të prokurorisë për pushimin e çështjes për shkak se ajo ishte parashkruar, ndërkohë ka ushtruar të drejtën e ankimit dhe sqaron se Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe kthimin e çështjes për hetime të mëtejshme, ndërsa pretendon se prokuroria nuk përmbushi detyrat e lëna dhe përsëriti të njëjtën vendimmarrje. Denoncuesja ka depozituar kërkimin e organit të akuzës drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, pas kryerjes së hetimeve të mëtejshme, ku nga relatimi i bërë në kërkesë, duket se e vetmja detyrë e lënë ka qenë ribërja e aktekspertimit lidhur me konkludimin e nënshkrimeve të personave nën hetim në referim të birësimit të ndodhur prej vitit 1991 me vendim gjyqësor. Organi i akuzës, pasi ka kërkuar dhe, më tej, ka administruar aktriekspertimin (sikurse thuhet në kërkesë të prokurorit) ka rikërkuar në gjykatë pushimin e çështjes, duke përfshirë rastin në nenin 66/ç të Kodit Penal (instituti i parashkrimit), për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, pasi kanë kaluar afatet procedurale.

10.1 Pas analizimit të kësaj çështjeje, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit lidhur me pretendimet e denoncueses, të mbështetura në dokumentacion³⁹, si dhe të qartësonte statusin aktual të çështjes.

10.2 Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të detajuara duke parashtruar: (i) rrethanat e faktit për këtë çështje; (ii) kryerjen e veprimeve hetimore dhe provat e marra gjatë hetimit nga ish-prokurori H. V. dhe oficeri i policisë gjyqësore I. H.; (iii) detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila me vendimin gjyqësor nr***, datë 10.7.2019, ka kërkuar të kryhej riekspertim pasi aktekspertimi grafik i administruar në dosje dhe konkluzionet nuk kishin qenë kategorike. Kjo dhe për faktin se ekspertët nuk kishin pasur sa më shumë modele të lira dhe modele krahasuese; (iv) ka shpjeguar se roli i tij në këtë çështje ka qenë pas prishjes së këtij vendimi, për të cilën ka kryer riekspertimin dhe veprime të tjera hetimore; (v) ka parashtruar një analizë juridike të provave dhe çështjes në tërësi lidhur me vendimmarrjen e tij, duke depozituar edhe dokumentacion mbështetës⁴⁰; (vi) ka parashtruar se ky vendim ka marrë formë të prerë më 21.7.2020, pasi nuk është ushtruar ankim nga palët e interesuara, si dhe as nga ankuesja N.C., e cila ka qenë e pranishme gjatë gjykimit dhe në dijeni të veprimeve të kryera gjatë hetimit të çështjes.

³⁷Nr. *** prot., datë 6.5.2021 dhe nr. *** prot., datë 2.3.2020.

³⁸Nisur nën akuzën për falsifikim dokumentesh, sipas nenit 186 të Kodit Penal.

³⁹Kërkesën e parë drejtuar gjykatës për pushimin e çështjes, vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat; vendimin e plotë të Gjykatës së Apelit Tiranë për kthimin e çështjes për hetime të tjera.

⁴⁰Kërkesa e parë për pushimin e çështjes nr. ***, të vitit 2018 - ish-prokurori H. V., 8 fletë; vendimi nr. ***, datë 22.5.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, 8 fletë; vendimi gjyqësor nr. ***, datë 10.7.2019, i Gjykatës së Apelit Tiranë, 12 fletë; kërkesë për pushimin e çështjes - subjekti i rivlerësimit Abaz Muça, 9 fletë; vendimi nr. ***, datë 3.7.2020, i Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Mat, marrë formë të prerë datë 21.7.2020, ndaj të cilit nuk është ushtruar ankim nga denoncuesja N. C., 8 fletë.

10.3 Trupi gjykues, lidhur me këtë çështje, arsyeton se: (i) provohet fakti që roli i subjektit në këtë çështje ka qenë pas prishjes nga Gjykata e Apelit Mat, të vendimit të pushimit të disponuar nga një tjetër subjekt rivlerësimi; (ii) nga subjekti i rivlerësimit janë kryer veprimet hetimore dhe se ky vendim është arsyetuar në vendimmarrjen e tij se jemi përpara një vepër penale e parashkruar sipas germës “ç”, të nenit 66, të Kodit Penal: “... kanë kaluar pesë vjet për veprat penale që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim”; (iii) vendimmarrja e subjektit ka marrë formë të prerë, si rrjedhojë e mosankimit nga pala dhe në këto rrethana trupi gjykues konkludon se nuk konstatohen problematika në ushtrim të detyrës së tij funksionale, në raport me komponentët e vlerësimit të tij profesional.

11. Në Komision, në datën 18.6.2021⁴¹, për subjektin e rivlerësimit Abaz Muça është paraqitur një denoncim, i përsëritur në përmbajtje edhe në datën 21.6.2021, me emër tjetër denoncuesi. Denoncuesit ankohen për shkelje të etikës profesionale nga subjekti i rivlerësimit Abaz Muça, duke parashtruar se ka miqësi me persona të dyshimtë, të cilët i kanë falur prokurorisë një automjet tip “Fuoristrad”, që është trafikuar dhe është përdorur nga subjekti, si dhe kanë kërkuar që Komisioni të verifikojë emërimin e tij si Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat, si dhe çështje të hetuara prej tij.

11.1 Lidhur me këtë denoncim, trupi gjykues, pas kryerjes së disa verifikimeve paraprake, përfshirë këtu edhe ato në median *online*⁴² apo edhe në dosjen e hetimit, çmoi⁴³ që ky denoncim t’i dërgohet subjektit për dhënien e shpjegimeve lidhur me pretendimet e denoncuesit dhe specifikisht për dy çështje të trajtuara më poshtë.

11.2 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se me shtetasin L.H. nuk ka pasur asnjë lidhje, as me cilësinë e prokurorit apo me atë të oficerit të policisë gjyqësore. Subjekti, për të konfirmuar këtë fakt, ka depozituar vërtetimin nr***prot., datë 21.6.2021, lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

11.3 Mbi pretendimet e denoncuesit për dyshime të emërimit të tij si Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat, subjekti ka sqaruar dhe dokumentuar se është emëruar me urdhrin nr. ***, datë 24.4.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm të kohës znj. Ina Rama “Për komandimin e prokurorit” dhe me urdhrin nr. ***, datë 17.7.2017, të Prokurorit të Përgjithshëm të kohës z. Adriatik Llalla “Për lirimin nga detyra të drejtuesit”, është liruar nga kjo detyrë. Ky urdhër sipas subjektit është bërë në mënyrë të njëanshme nga ish-Prokurori i Përgjithshëm i kohës, pasi ka qenë i caktuar në atë detyrë sipas ligjit të kohës dhe, për më tepër, nuk ka pasur ndonjë kërkesë të tij për dorëheqje, ndryshe nga sa është parashtruar në këtë urdhër.

11.4 Lidhur me blerjen e automjetit tip “Fuoristrad Mitsubishi” të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat, subjekti ka shpjeguar se është blerë sipas urdhërprokurimit nr. ***, datë 31.10.2001, të nxjerrë nga ish-prokurori i rrethit të kohës z. K. B. . Ka depozituar procesverbalin datë 12.12.2001, nga ku pasqyrohet fakti se subjekti i rivlerësimit Abaz Muça, me funksion Oficer i Policisë Gjyqësore në atë kohë, në cilësinë e anëtarit, nuk ka nënshkruar.

11.5 Në vijim, subjekti ka parashtruar se ky denoncim nuk është bërë nga publiku, pasi nga verifikimi me institucionet përkatëse rezultoi se me të dhënat e paraqitura në denoncim nuk ekziston asnjë person me këto të dhëna që është banor i Matit. Subjekti shprehet se ky denoncim është bërë nga ish-kolegët e tij, të cilët me dashje kanë dashur të hedhin baltë mbi personalitetin e tij, për shkak të kërkesës së llogarisë që ka kërkuar në funksion të veprimtarisë ligjore dhe kushtetuese për të rritur besimin e publikut në luftën kundër korrupsionit dhe krimin, si dhe performancës dhe cilësisë së hetimeve në institucionin që ushtronte detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë.

⁴¹Referojuni denoncimit datë 18.6.2021, i përsëritur më 21.6.2021.

⁴² <https://www.gazetatema.net/2016/10/06/nje-prokuror-trim-qe-shkon-i-vetem-te-zbuloje-arrat-me-hashash/>

⁴³Referojuni procesverbalit datë 21.6.2021.

11.6 Për të mbështetur shpjegimet e tij, subjekti ka depozituar dokumentacion⁴⁴.

11.7 Më tej, subjekti ka shpjeguar rrethanat e ngjarjes mbi procedimin penal nr. ***, të vitit 2010, në ngarkim të të pandehurit A. D., akuzuar për veprën penale “kallëzim i rremë”, të parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal, analizën e provave të marra gjatë shqyrtimit gjyqësor, si dhe ka depozituar vendimet gjyqësore⁴⁵ lidhur me çështjen.

11.8 Subjekti ka shpjeguar, në vijim, rrethanat e ngjarjes ndaj kërkesës së të dënuarit K.N., për lirimin e tij me kusht për pjesën e pa vuajtur të dënimit. Në fazën e gjykimit të kësaj çështjeje penale është kërkuar zëvendësimi i subjektit, ku është vendosur mospranimi i kërkesës për zëvendësimin e prokurorit Abaz Muça. Me vendimin nr***, datë 25.7.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka vendosur: “Pushimin e gjykimit të çështjes”. Ky vendim ka marrë formë të prerë më 7.8.2018, pasi i dënuari hoqi dorë nga kërkesa e tij për lirim para kohe me kusht. Subjekti ka depozituar dokumentacion⁴⁶ mbështetës.

11.9 Trupi gjykues, lidhur me pretendimet e denoncuesit, në raport me shpjegimet dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti, arsyeton se:

11.10 Lidhur me pretendimin për lidhje të tij me persona të dyshimtë ka konstatuar se në raportin e DSIK- së (i përditësuar në maj të vitit 2021), por edhe nga hetimi i Komisionit për vlerësimin e kriterit të figurës, nuk është evidentuar ndonjë *indicie* apo e dhënë që mund të kompromentonte figurën e tij.

11.11 Për pretendimin për automjetin, përtej shpjegimeve të subjektit, paraprakisht konstatoi se: (i) denoncuesi nuk ka vënë në dispozicion ndonjë provë për të bërë të mundur provueshmërinë e këtij denoncimi, ndërsa nga dokumentacioni i administruar si në hetimin e Komisionit, por edhe nga provat e depozituara nga subjekti rezultoi se ky i fundit në kohën e tenderimit të automjetit kishte mbajtur detyrën e OPGJ-së në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat dhe se në procesverbalin e mbajtur nga komisioni i tenderimit nuk kishte nënshkruar; (ii) nga aksesi në AMF rezultoi se targat e automjetit figuronin në emër të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat; (iii) po nga hetimi administrativ i Komisionit nuk rezultoi ndonjë marrëdhënie kontraktore apo dhurimi për ndonjë automjet në adresë të subjektit.

⁴⁴ Vërtetimi nr***prot., datë 21.6.2021, i Zyrës së Regjistrimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, 1 fletë; Urdhri nr. ***, datë 24.4.2012, i Prokurorit të Përgjithshëm Ina Rama “Për komandimin e prokurorit”, 1 fletë. Urdhri nr. ***, datë 17.7.2017, i Prokurorit të Përgjithshëm A. Llalla “Për lirimin nga detyra të drejtuesit”, 1 fletë. Dokumentacion mbi blerjen e automjetit tip “Fuoristradë Mitsubishi”, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat, 4 fletë.

⁴⁵Vendimi nr. ***, datë 4.10.2011, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat që ka vendosur: Pushimi i çështjes në ngarkim të të pandehurit A. D. . Ky vendim ka marrë formë të prerë më 15.7.2011, pasi nuk është ushtruar ankimi nga palët e interesuara; vendimin e mosfillimit të procedimit penal nr. ***, datë 16.6.2015, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë; urdhër për regjistrimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2010 - ish-Drejtuesi i Prokurorisë L. Ç., 2 fletë; urdhër për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale datë 12.10.2010, 4 fletë; kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr***, të vitit 2010, 5 fletë; konkluzione përfundimtare për procedimin penal nr. ***, të vitit 2010, në ngarkim të të pandehurit A.D., 5 fletë; vendimi nr***, datë 4.7.2011, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, 3 fletë; vendimi i mosfillimit datë 16.6.2015, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë për materialin kallëzues nr. ***, të vitit 2015, 4 fletë; deklaratë e shtetasit A. D. datë 7.5.2018, 1 fletë; urdhër për regjistrimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2021, 5 fletë; urdhër për kryerjen e veprimeve hetimore për procedimin penal nr. ***, të vitit 2021, 6 fletë.

⁴⁶Vendimi nr. ***, datë 25.7.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, 3 fletë; procesverbale të seancës gjyqësore për kërkesën e të dënuarit K.N.për lirim para kohe me kusht, 17 fletë; kërkesë për zëvendësimin e prokurorit Abaz Muça, 2 fletë; vendim për mospranimin e kërkesës së shtetasit K.N. për zëvendësimin e prokurorit, 4 fletë; vendimi nr***, datë 8.5.2009, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, 2 fletë; vendimi nr. ***, datë 23.3.2003, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, 14 fletë; vendimi nr. ***, datë 10.5.2006, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, 14 fletë; raport vlerësimi datë 21.5.2018, i Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës Mat, 9 fletë; dokumentacion mbi të dënuarin K. N., 4 fletë.

11.12 Lidhur me procedimin penal nr. ***, të vitit 2010, në ngarkim të të pandehurit A. D., i akuzuar për veprën penale “kallëzimi i rremë”, si dhe për çështjen K. N., trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer ndonjë shkelje të natyrës procedurale dhe se pretendimet e denoncuesit nuk qëndrojnë. Kallëzimi i rremë kishte ardhur si pasojë e pushimit të veprës penale të kanosjes për të cilën fillimisht ishte regjistruar procedimi penal i vitit 2010, vendim ky i paankimuar. Qëndron shpjegimi i dhënë nga subjekti se konkluzionet përfundimtare janë diskutuar, dakordësuar dhe miratuar sipas ligjit në fuqi të asaj kohe nga ish-Drejtuuesi i Prokurorisë. Gjithashtu, trupit gjykues i rezultoi se shtetasi A.D. ka pohuar dhe deklaruar se nuk ka adresuar ndonjë kallëzim ndaj subjektit. Edhe sa i përket çështjes N. u vërtetua plotësisht se subjekti i kishte qëndruar konkluzionit përfundimtar për mospranim të kërkesës së këtij të dënuari për lirim para kohe me kusht, arsye kjo që kishte vendosur të dënuarin në pozitën e tërheqjes së kërkesës. Po ashtu, edhe për pretendime të denoncuesve që lidhen me çështjen e përfaqësuar nga av. B. R., si dhe për të dënuarin M.K., trupi gjykues i analizoi këto raste që në rezultatet e hetimit administrativ për të cilat nuk u evidentuan problematika që mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit.

11.13 Komisioni, në analizë të ankesave të trajtuara në raportin profesional për subjektin e rivlerësimit, vlerësoi të kërkojë informacion, kopje të fashikujve penalë, por edhe statusin aktual të çështjeve të prezantuara nga shtetasi V.K., i cili më parë kishte vënë në lëvizje Prokurorinë e Krimeve të Rënda me ankesën e tij ndaj subjektit të rivlerësimit, duke deklaruar se kishte qenë në rolin e sekserit në disa çështje të hetuara nga ky i fundit (kërkimi nga Komisioni u vlerësua pavarësisht faktit se nga hetimi i organit të akuzës/Prokuroria e Krimeve të Rënda ka rezultuar se shtetasi K. e ka mohuar depozitimin e ankesës së tij dhe, po ashtu, edhe nënshkrimin e saj).

11.14 Komisioni administroi informacionin e përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat⁴⁷, ku qartësohet lidhur me statusin e secilit procedim penal, si dhe fashikujt përkatës në ngarkim të shtetasve G.L., M. K., F. N., si dhe Sh.H.⁴⁸, etj.

11.15 Lidhur me procedimin penal nr. ***, datë 27.3.2012, regjistruar në ngarkim të pandehurit G.L., për kryerjen e veprës penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal, rezulton se subjekti i rivlerësimit në konkluzionet e tij ka kërkuar deklarimin fajtor të të pandehurit G.L. dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me vendimin nr. ***, datë 11.6.2013 (të formës së prerë), ka vendosur të njëjtën masë dënimi me atë të kërkuar nga organi i akuzës, por duke lehtësuar pozitën e të pandehurit në vuajtjen e dënimit, duke urdhëruar në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien e të pandehurit në kohë prove për 5 vjet, duke mbajtur kontakt për këtë periudhë me shërbimin e provës.

11.16 Lidhur me procedimin penal nr. ***, regjistruar më 31.1.2013, në ngarkim të të pandehurit M. K., për kryerjen e veprave penale “vrasje me dashje mbetur në tentativë” dhe “mbajtje pa leje e armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 76 -22 dhe 278/2 të Kodit Penal rezulton se subjekti i rivlerësimit, në konkluzionet përfundimtare, ka kërkuar dënimin e këtij të pandehuri me 2 vjet burgim, në bashkim të dënimeve për veprat penale “kanosje” dhe “mbajtje pa leje të armëve luftarake”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me vendimin nr. ***, datë 13.9.2013, ka vendosur dënimin e këtij të pandehuri me 15 muaj burgim, në bashkim të dënimeve për veprat penale “kanosje” dhe “mbajtje pa leje të armëve luftarake” dhe në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal ka urdhëruar

⁴⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 31.5.2021.

⁴⁸ Çështjet në ngarkim të këtij shtetasi dhe të tjerëve së bashku, akuzuar për veprën penale “vjedhje me armë, kryer në bashkëpunim”, i përkasin procedimit penal të vitit 2000, kohë kur subjekti nuk kishte detyrën e prokurorit.

pezullimit të këtij dënimi, duke e vënë të pandehurin në kohë prove për 18 muaj, si dhe urdhërimin e lirim të menjëhershëm të tij nga dhomat e paraburgimit.

Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim nga subjekti i rivlerësimit në Gjykatën e Apelit Tiranë. Kjo e fundit, me vendimin nr***, datë 19.3.2014, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat”.

Ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit është ushtruar rekurs.

Gjykata e Lartë, me vendimin e saj nr. 1286, datë 12.6.2015, ka vendosur mospranimin e rekursit.

11.17 Lidhur me procedimin penal nr. ***, regjistruar më 19.12.2012, në ngarkim të të pandehurit F. N., për kryerjen e veprave penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, mbetur në tentative” dhe “mbajtje pa leje e armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 79/ë-22 dhe 278/2 të Kodit penal, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka kërkuar deklarinim fajtor të këtij shtetasi nën akuzën e lartpërmendur dhe në bashkim të dënimeve për secilën vepër penale ka kërkuar dënimin e tij me 20 vjet burgim.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me vendimin nr. ***, datë 16.4.2014, në bashkim të dënimeve për akuzën “vrasje nga pakujdesia”, mbetur në tentativë dhe “mbajtje pa leje e armëve luftarake”, ka vendosur dënimin e këtij të pandehuri me 2 vjet burgim.

Ndaj këtij vendimi subjekti ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Kjo e fundit me vendimin e saj nr. ***, datë 4.6.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, duke pushuar çështjen për akuzën e parë ndaj të pandehurit dhe dënimin e tij me 2 vjet e 6 muaj burgim për akuzën “mbajtje pa leje të armëve luftarake”.

Ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr. 2178, datë 9.12.2016, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Për sa u arsyetua më sipër, trupi gjykues pas analizimit të denoncimeve referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe çdo çështje tjetër të dalë gjatë hetimit, ka vlerësuar se në tërësi ato nuk përmbajnë fakte apo rrethana konkrete që të përbëjnë shkelje të rënda dhe të përsëritura, të cilat mund të ndikojnë në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional⁴⁹ për subjektin e rivlerësimit.

Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, çmon se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përmbushje të parashikimit të germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016 dhe për këtë shkak konsiderohet “i aftë”.

⁴⁹ Neni E, pika 1, të Aneksit të Kushtetutës, i cili përcakton se: “Vlerësimi i aftësive profesionale ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale, që mund të korrigjohen përmes edukimit”; - Neni 59 i ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit: “Vlerësimi i aftësive profesionale parashikon arritjen e një niveli minimal kualifikues”; - Vendimi nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, ku në pikën 54 përcaktohet se: “...në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjytimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shih edhe opinionin CDL -AD (2016) 036 të Komisionit të Venecias).

Vlerësimi i çështjes në tërësi nga trupi gjykues

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara prej tij, çmon se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e saj nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.
- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti plotëson kushtet e nenit 59/1,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Abaz Muça, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 23.6.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda ÇIFTJA
Kryesuese

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Lulzim HAMITAJ
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta